



UNIVERSITETI I EVROPËS JUGLINDORE
УНИВЕРЗИТЕТ НА ЈУГОИСТОЧНА ЕВРОПА
SOUTH EAST EUROPEAN UNIVERSITY

Fakulteti i Drejtësisë

STUDIME PASDIPLOMIKE - CIKLI I DYTË

TEZA:

**PROCEDURAT E VEÇANTA NDAJ FËMIJËVE KRYERËS TË VEPRAVE PENALE NË
REPUBLIKËN E MAQEDONISË SË VERIUT DHE NË DISA VENDE EUROPIANE**

Kandidati :

Amir Huseini

Mentor:

Prof. Doc.Dr. Blerta Ahmedi Arifi

Tetovë, Dhjetor 2021

DEKLARATA E AUTORËSISË DHE FALEMINDERIME

Deklaroj se ky punim është shkruar nga ana ime dhe nuk përmban materiale nga persona të tjerë, përveç të dhënave të referuara duke i respektuar rregullat e citimit.

Shpreh vlerësim dhe mirënjohje të veçantë për Prof.Doc.Dr. Blerta Ahmedi Arifi për gjithë mbështetjen dhe mirëkuptimin e saj.

ABSTRAKT

Kriminaliteti tek fëmijët, është një fenomen shqetësues për shoqërinë tonë bashkëkohore por dhe mbarë shoqëritë në botë. Duke e pasur parasysh që përmasat e këtij fenomeni janë në rritje gjithmonë e më shumë, trajtimi në mënyrë të detajuar i gjithë elementeve përbërëse të kësaj forme të shprehjes së zhvillimit të kriminalitetit, në aspektin kriminologjik dhe penologjik është dukshëm i nevojshëm.

Objekt i këtij punimi do të jenë: Procedurat e veçanta të cilat mund të zbatohen ndaj fëmijëve të gjykuar të parapara me dispozitat e LDF-së. Një trajtesë të veçantë do të kenë dhe aspekte të përgjegjësisë penale tek fëmijët, mosha për përgjegjësinë penale dhe qëndrimet në lidhje me kufirin e kësaj moshe. Po aq rëndësi do ti kushtohet procedimit penal të të miturve¹ me trajtime teorike dhe problematika të ndryshme të praktikës, e deri te garancitë e veçanta procedurale. Një vend të rëndësishëm do zë edhe sistemi i dënimeve dhe masat edukuese, dënimet alternative në ndihmë të rehabilitimit të fëmijëve të përfshirë në krime, si dhe efikasiteti i politikave penitenciare që shteti ndërmerr ndaj fëmijëve. Studimi do të fokusohet edhe në qasje komparative me legjislacionet e disa shteteve të rajonit dhe europiane sa i përket objektit të studimit të këtij studimi, do të pasojë dhe një trajtesë krahasimore me vendet e zhvilluara, duke argumentuar dhe qëndrimin tonë në lidhje me çështjet që janë objekt të këtij studimi.

¹ Më tej në vend të termit të mitur kryerës të veprave penale do të përdoret termi fëmijë kryerës të veprave penale.

Abstract

Juvenile delinquency is a worrying phenomenon for our contemporary society but also for each society in the world. Given that the scale of this phenomenon is increasing, the treatment in detail of all the constituent elements of this form of expression and development of crime, in terms of criminology and penology is clearly necessary.

The object of this paper will be: Special procedures which can be applied to convicted children provided by the provisions of the Law. Aspects of criminal responsibility of juveniles, age for criminal responsibility and attitudes regarding the limit of this age will also have a special treatment. Equally importance will be given to the criminal proceedings of juveniles with theoretical treatments and various problems of practice, up to special procedural guarantees. An important place will also be occupied by the system of punishments and educational measures, alternative punishments, in aid of the rehabilitation of juveniles involved in crimes, as well as the effectiveness of penitentiary policies that the state undertakes towards juveniles². The study will also focus on presenting the different approaches that European countries have regarding the treatment of juvenile delinquents in criminal proceedings, there will be a comparative treatment with developed countries, arguing our position on the issues in question of this study.

² Hereafter, the term juvenile delinquency will be replaced with the term child delinquency and all the following mentions on juvenile will apply the same rule of mentioning during this research paper.

Përmbajtja

DEKLARATA E AUTORËSISË DHE FALEMINDERIME	2
ABSTRAKT	3
Abstract	4
Lista e shkurtimeve	7
Hyrje	8
Hipoteza e studimit	9
Metodologjia dhe metodat kërkimore	9
Burimi dhe analiza e të dhënave	12
Statistika përshkruese	13
Rëndësia e studimit	13
Përmbledhja dhe strukturimi i studimit	14
KAPITULLI I	16
Përkufizimi i nocionit fëmijë dhe kategorizimi i fëmijëve në grupe të ndryshme sipas Ligjit për drejtësinë e fëmijëve	16
1.1 Dispozita të përgjithshme dhe parime lidhur me procedurën për fëmijë	16
1.2 Kushtet për iniciimin e procedurës ndaj fëmijëve kryerës të veprave penale	19
1.3 Procedura përgatitore	20
1.4 Qëllimi i aplikimit të procedurave të veçanta ndaj fëmijëve	20
1.5 Burimet e të drejtës penale për fëmijë në RMV	21
1.5.1. Burimet nacionale të të drejtës penale për fëmijë	21
1.5.2 Burimet ndërkombëtare të të drejtës penale për fëmijë	22
KAPITULLI II	27
Procedurat e veçanta ndaj fëmijëve	27
2.1. Procedura për ndërmjetësim	27
2.2 Karakteristikat e procedurës ndaj fëmijëve	28
2.3 Llojet e tjera të procedurave të veçanta sipas LDF-së të RMV-së	28
2.3.1 Procedura për shqiptimin e masave të ndihmës dhe mbrojtjes	28
2.3.2 Procedurat për zbatimin e masave parandaluese ndaj fëmijës	30
2.3.3 Procedura për pranimin e përgjegjesisë dhe marrveshja për lartësinë e dënimit	31
2.3.4 Masat edukative	31
2.3.5 Masat edukativo përmirsuese	32
2.3.6 Aplikimi i masave edukuese të kontrollit të shtuar ndaj të miturve	32
2.3.7 Mbikqyrja e shtuar nga ana e entit për punë sociale	33

2.3.8 Aplikimi i masave edukuese institucionale ndaj të miturve.....	33
2.3.9 Aplikimi i sanksioneve për fëmijët kryerës të veprës penale.....	34
Burgu për të mitur	34
2.3.10 Trajtimi ligjor i fëmijëve në rastet e paraburgimit	34
2.3.11 Garancitë ligjore në procesin gjyqësor ndaj fëmijëve	35
2.3.12 Zhvillimi i procedurave të veçanta ndaj fëmijëve	35
Elementet restorative gjatë veprimit të gjykatës me fëmijët	35
KAPITULLI III	37
Procedurat e veçanta ndaj fëmijëve kryerës të veprave penale në disa vende europiane ...	37
3.1 Kroacia: Sigurimi i procedurave të veçanta dhe vlerësimi i pjekurisë - Juridiksioni i sistemit të drejtësisë për fëmijë.....	40
3.2 Fëmijë të rinj në sistemin e drejtësisë	41
3.3 Roli i policisë, prokurorëve dhe gjykatave	42
3.4 Sanksionet dhe masat e zbatueshme	48
3.5 Burgu për fëmijë (neni 23 i LGJM).....	49
3.6 Masat e Sigurisë (neni 30 i LGJM).....	50
3.7 Historiku i përgjegjësisë penale ndaj të fëmijëve në Republikën e Shqipërisë.....	52
3.8 Kodi i Drejtësisë Penale për fëmijë i Republikës së Shqipërisë.....	53
3.9 Qasja shumëdisiplinore në Drejtësinë Miqësore për fëmijë	54
KAPITULLI IV	56
Të dhënat empirike lidhur me procedurat e veçanta ndaj fëmijëve në RMV	56
4.1 Numri i rasteve të aplikimit të procedurave të veçanta te fëmijët kryerës të veprave penale në RMV	56
4.2 Të dhëna statistikore për fëmijë të përfshirë në sistemin e drejtësisë për Republikën e Kroacisë	60
4.3 Të dhëna statistikore për fëmijë të përfshirë në sistemin e drejtësisë për Republikën e Shqipërisë.....	68
Përfundime dhe rekomandime	72
Parandalimi dhe ndërhyrja si masa rekomanduese	73
Modelet e suksesshme të parandalimit të kriminalitetit të fëmijëve	73
KONKLuzion	74
BIBLIOGRAFIA	77

Lista e shkurtimeve

KP - Kodi Penal

RMV Republika e Maqedonisë së Veriut

BE Bashkësia Europiane

CLS Comparative Legal Studies

R.SH Republika e Shqipërisë

KPM Kodi Penal i Maqedonisë

LDF Ligji për të drejtat e fëmijëve

DHKA Dhoma Kombëtare e Avokaturës

LGJM Ligji i Gjykatës për të Miturit

KE Këshilli i Europës

KDPM Kodi i Drejtësisë Penale për të Mitur

Hyrje

Përfshirja e fëmijëve në strukturat kriminale ka ardhur gjithnjë e duke u rritur, kjo sepse shumë grupe kriminale i përdorin fëmijët për të realizuar synimet e tyre kriminale, nisur dhe nga shfrytëzimi i zbrazëtirave ligjore në lidhje me legjislacionin e fëmijëve. Zhvillimet ekonomike dhe transformimet e shumëta shoqërore kanë ndikuar në rritjen e fenomenit të kriminalitetit tek fëmijët.

Në kuadër të luftës kundër kriminalitetit të fëmijëve janë bërë ndryshime të shumta legislative por vazhdon të jetë ende sfidues realizimi i ndryshimeve institucionale të cilat do të bënin të mundur efikasitet të normave ligjore.

Qëllimi i këtij studimi është paraqitja e procedurave të veçanta ndaj fëmijëve kryerës të veprave penale në Republikën e Maqedonisë së Veriut. Do të paraqiten dallimet krahasimore me republikën e Kroacisë dhe republikën e Shqipërisë lidhur me procedurat e veçanta që mund të zbatohen ndaj fëmijëve.

Nëpërmjet këtij punimi kemi si objektivi:

- a) Analizimi i situatës aktuale mbi kriminalitetin e fëmijëve;
- b) Identifikimi dhe analizimi i faktorëve nxitës të kriminalitetit tek fëmijët si dhe evidentimi i shpraztirave ligjore në lidhje me drejtësinë e fëmijëve.
- c) Identifikimi i veprimeve dhe masave që duhet të ndërmerren nga shteti për luftimin dhe parandalimin e këtij fenomeni që po shqetëson shoqërinë tonë.

Qëllimi i këtij studimi është gjithashtu të propozojë edhe disa rekomandime të zbatueshme për të gjithë aktorët e përfshirë në hartimin dhe në zbatimin e legjislacionit, me qëllim minimizimin e kriminalitetit tek fëmijët si një fenomen me influencë negative për shoqërinë me pasoja afatgjate dhe shumë të dëmshme, duke pasur prioritet mbrojtjen dhe interesin më të lartë të fëmijëve.

Për faktin që sfidat që na paraqiten janë të pafundme dhe të paparashikueshme, ajo që është e rëndësishme është që sistemi ligjor në çdo fazë, duhet ti përgjigjet në mënyrë sa më të mirë, më

të shpejt dhe me kosto sa më të ulët kërkesave dhe sfidave të të sotmes dhe perspektivave të së ardhmes në mënyrë që sistemi ligjor të prevalojë në interes më të lartë të fëmijëve kryerës të veprave penale.

Si çdo studim ashtu edhe ky, është zhvilluar duke nisur nga pyetjet kërkimore. Pyetjet kërkimore shërbejnë për filtrimin e hulumtimit dhe evidentimin e rëndësisë së tij. Në këtë studim trajtohet në mënyrë të detajuar fenomeni i kriminalitetit tek fëmijët duke bërë një analizë e kuadrit ligjor dhe zbatimit të tij ndaj fëmijëve autorë të veprave penale. Në këtë studim do t'u jepen sqarime më të zgjeruara rreth çështjeve të mëposhtme: Përkufizimi i termit fëmijë dhe koha në të cilën fillon përgjegjsia e tyre penale, cilët janë faktorët e brendshëm dhe të jashtëm të cilët ndikojnë në rrjetin e kriminalitetit tek fëmijët, a ekziston trajtim i veçantë për mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve duke i favorizuar ata, cilat janë aktet ndërkombëtare dhe rajonale të cilat janë të integruara në sistemin e brendshëm të RMV për mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve, cilat janë problematikat që has legjislacioni penal për fëmijët në zbatimin e tij në praktikë, dhe a gëzojnë mbrojtje të posaçme fëmijët që vuajnë dënime penale në institucionet përkatëse me kuadrin ligjor ekzistues?

Hipoteza e studimit

Hulumtimi do të ketë dhëna nga ligjet shtetërore dhe institucionet shtetërore përkatëse të cilat janë kompetente për procedurat e veçanta ndaj fëmijëve kryerës të veprave penale.

Procedurat e veçanta në Republikën e Maqedonisë së Veriut nuk japin rezultat të dobishëm ose adekuat për arritjen e qëllimit të duhur për kryerësit fëmijë të veprave penale.

Metodologjia dhe metodat kërkimore

Metodologjia dhe metodat e kërkimit shkencor përbëjnë një nga shtyllat më të rëndësishme mbi të cilat ndërtohet studimi. Përdorimi i tyre është esencial në një studim dhe përfaqëson një reflektim të logjikshëm të analizës shkencore të projekteve hulumtuese. Ky studim ka në fokus trajtimin e konceptit fëmijë, fillimin e përgjegjësisë penale, evidentimin e faktorëve që çojnë në përfshirjen e tyre në aktivitetet kriminale dhe trajtimin e kontekstit ligjor duke u bazuar në

procedurat e veçanta që aplikohen ndaj fëmijëve kryerës të veprave penale. Për të arritur objektivat e këtij studimi kemi kombinuar disa prej metodave shkencore më të përdorura të cilat do të sqarohen në vijim.

Metoda hulumtuese e përdorur në studim përfshin procesin e mbledhjes së materialeve në forma të shkruara dhe elektronike. Janë analizuar dhe paraqitur të dhëna nga enti zyrtar statistikor i vendit tonë, i Kroacisë dhe Shqipërisë rreth numrit të fëmijëve të dënuar për kryerje të veprave penale nga viti 2016 e deri në 2020.

Duke marrë parasysh se studimi ynë është i bazuar në ligje dhe dispozita të ndryshme të disa shteteve përfshirë edhe vendin tonë si bazë kryesore e krahasimeve të lidhshmërisë dhe efikasitetit të ligjeve të paraparë për trajtimin e fëmijëve, në këtë studim është përdorur metoda krahasuese ligjore e njohur si Studime Ligjore Krahasuese (angl. Comparative Legal Studies).

Thënë kështu, studiuesit mund të humbasin lehtësisht kur fillojnë hulumtimet krahasuese ligjore. Arsyeja kryesore është se nuk ekziston marrëveshje për llojin e metodologjisë që do të ndiqet. Për më tepër, pothuajse gjithçka që është vendosur pak a shumë në fushën e së drejtës krahasuese gjatë shekullit të kaluar është kritikuar gjithnjë e më shumë gjatë dekadave të fundit: si koncepti i 'familjes ligjore', mundësia e vetë krahasimit, objekti i krahasimit, etj.

Nga ana tjetër, krahasimi i ligjit me mënyrën e rregullimit të së njëjtës fushë në një ose më shumë vende është bërë pothuajse i detyrueshëm në hulumtimet ligjore doktrinale. Gjithashtu në praktikën ligjore, globalizimi dhe më së shumti evropianizimi përfshin hulumtime krahasuese gjatë konstruimit të studimeve hulumtuese.

Në fund të shekullit të nëntëmbëdhjetë dhe në fillim të shekullit të njëzetë, në Francë, Raymond Saleilles dhe të tjerë, e panë të drejtën krahasuese kryesisht si një instrument për përmirësimin e ligjit të brendshëm dhe doktrinës ligjore, si një mënyrë për të rinovuar qasjen e fosilizuar të Shkollës Exegjetike ende mbizotëruese në Kodin Civil dhe interpretimin i tij (Saleilles 1911, f. 22) (cituar nga Van Hoecke, 2015)

Deri në fund të shekullit të njëzetë, shumë studiues juridikë në Evropë e konsideruan të drejtën krahasuese si instrument të nevojshëm për një harmonizim (të dëshirueshëm) të ligjeve brenda BE-së.

Në mënyrë të përgjithshme, Patrick Glenn i është përgjigjur kësaj pyetjeje nën titullin 'Qëllimet e së drejtës krahasuese', (a) ligji krahasues si një instrument i shkencës evolucionare dhe taksonomike (evolucionet e zakonshme, ndryshimet diakronike, familjet ligjore), (b) kontribuimi në sistemin ligjor të ndonjë vendi (duke e kuptuar atë më mirë, përfshirë rezistencën e traditave të tij, duke e përmirësuar atë, duke e përdorur atë si një mjet për interpretimin e kushtetutës), dhe (c) harmonizimin e ligjit. Sidoqoftë, Glenn kritikon ashpër pjesën më të madhe të ideologjisë që qëndron në themelet e së drejtës tradicionale krahasuese dhe që kryesisht e bën edhe sot (Van Hoecke, 2015, f. 2).

Ndonjëherë 'krahasimi' konsiderohet të jetë një 'metodë' më vete dhe quhet metoda krahasuese 'pa shpjegime të mëtejshme ose udhëzime konkrete. E vetmja 'metodë' e propozuar në literaturën krahasuese, e cila shkon një hap më tej, është e ashtuquajtura 'metoda funksionale'. Është një udhëzues konkret në atë që sugjeron të përqendrohemi në problemet ligjore dhe zgjidhjet ligjore në sistemet ligjore të krahasuara, sesa në rregullat (e ndryshme) dhe kornizat doktrinare. Sidoqoftë, disa elemente për metodat e tjera krahasuese mund të gjenden në literaturë, kryesisht në fushën e teorisë juridike. Mbi bazën e këtyre shkrimeve, ne mund të dallojmë gjashtë metoda të ndryshme për kërkime krahasuese: metoda funksionale, metoda strukturore, metoda analitike, metoda ligji-në-kontekst, metoda historike dhe metoda thelbësore (Van Hoecke, 2015, f. 8)

Praktikueshmëria e ligjit në praktikë dhe në teori - Në të vërtetë, ligji në praktikë mund të jetë (krejt) i ndryshëm nga ligji në libra. Shumica e avokatëve e dinë mirë këtë përfundim. Kjo është arsyeja pse një krahasim në nivelin e rregullave duhet të plotësohet, ose në disa raste të fillohet me, një krahasim të vendimeve gjyqësore. Sidoqoftë, në çdo hulumtim thelbësor në të drejtën krahasuese, si legjislacioni ashtu edhe praktika gjyqësore do të duhet të studiohen, pasi që, në të gjitha sistemet juridike, e drejta zakonore dhe e drejta civile, që të dyja kanë rëndësi vendimtare për njohjen e ligjit.

Planifikimi i modelit të kërkimit është një hap kryesor në çdo studim sociologjik. Të gjitha studimet formojnë modelin e hulumtimit, ndërsa dizajni hulumtues formon njëkohësisht studimin. Studiuesit zgjedhin metoda që i përshtaten më mirë temave të tyre të studimit dhe që përshtaten me qasjet e tyre të përgjithshme për kërkimin.

Në planifikimin e hartimeve të studimeve, sociologët zakonisht zgjedhin nga katër metoda të përdorura gjerësisht të hetimit shoqëror: studimi, hulumtimi në terren, eksperimenti dhe analiza sekondare e të dhënave, ose përdorimi i burimeve ekzistuese. Çdo metodë e hulumtimit vjen me gjëra pozitive dhe negative, dhe tema e studimit ndikon fuqimisht se cila metodë ose metoda vendosen për t'u përdorur. (Van Hoecke, 2015, f. 22)

Burimi dhe analiza e të dhënave

Gjatë konstruimit të këtij studimi janë përdorur të dhëna nga Entet Statistikore të shteteve të Republikës së Maqedonisë Veriore, Republikës së Shqipërisë si dhe shtetit Kroat. Të dhënave statistikore si dhe për analizë të gjendjes vjetore të shteteve në fjalë për intervalin kohor prej viteve 2015 deri 2019 u janë bashkangjitur edhe Raporte nga Zhurnale të publikuara online dhe Raporte të shteteve europiane.

Në Fjalorin e ri Kolegjial të Webster-it të vitit 1973 i quan të dhënat si "informacione faktike (si matje ose statistika) të përdorura si bazë për arsyetim, diskutim ose llogaritje". (B. Richmond, 2006, f. 5)

Në anën tjetër Analiza përshkruese statistikore karakterizon një fenomen duke identifikuar modelet në të dhëna për t'iu përgjigjur pyetjeve se kush, çfarë, ku, kur dhe në çfarë mase. Analiza përshkruese është thjeshtimi i të dhënave. Përshkrimi i mirë paraqet atë që dimë për kapacitetet, nevojat, metodat, praktikat, politikat, popullatat dhe cilësimet në një mënyrë që është e rëndësishme për një kërkim specifik. Analiza përshkruese mund të qëndrojë më vete si një produkt hulumtues, si p.sh. kur identifikon fenomene ose modele në të dhëna që nuk janë njohur më parë.

Zbatimi i metodës shkencore i zhvillon njohuritë përmes vëzhgimit të fenomeneve, identifikimin e pyetjeve, gjenerimin e hipotezave, testimin e hipotezave, dhe më pas prodhimin e vëzhgimeve, pyetjeve dhe hipotezave të reja. Analiza përshkruese është një përbërës themelor i këtij procesi

për shkak të rolit që ajo luan për të na ndihmuar të vëzhgojmë botën ose një fenomen dhe, më pas, në identifikimin e pyetjeve kërkimore dhe gjenerimin e hipotezave bazuar në ato që janë vërejtur. (Loeb dhe Dynarski, 2017, f. 1)

Statistika përshkruese

Statistikat përshkruese janë metoda tabelare, grafike dhe numerike me të cilat mund të përshkruhen tiparet thelbësore të një mostre. Megjithëse të njëjtat metoda mund të përdoren për të përshkruar popullata të tëra, ato aplikohen më shpesh në mostra në mënyrë që të kapen karakteristikat e popullsisë me anë të konkluzioneve.

Në të kundërt, të dhënat sasiore lindin kur karakteristikat që vërehen mund të përshkruhen me numra. Të dhënat sasiore diskrete janë të numërueshme ndërsa të dhënat e vazhdueshme mund të marrin ndonjë vlerë, përveç çdo kufizimi precize të vendosur nga instrumenti matës. (Delorme, A. 2006, f. 2)

Rëndësia e studimit

Aktualisht mbrojtje e të drejtave të fëmijëve përbën një prioritet të sistemit tonë të drejtësisë dhe një sfidë për shoqërinë. Rritja e numrit të fëmijëve të përfshirë në vepra të ndryshme penale është një tregues që sistemi ligjor ka dështuar në përdorimin e mekanizmave të tij. Mungesa e masave social-ekonomike në drejtim të familjeve ka rol të rëndësishëm që l'çon fëmijët në konflikt kundër ligjit.

Mosfunksionimi i strukturave përgjegjëse për integrimin social të fëmijëve, mungesa e institucioneve të mirëfillta për rehabilitimin e fëmijëve në konflikt me ligjin, mungesa e strukturave përgjegjëse për parandalimin e kryerjes së veprave penale janë disa nga problematikat kryesore të sistemit tonë ligjor.

Edhe pse vitet e fundit në Republikën e Maqedonisë Veriore janë bërë hapa pozitive në qasjen e legjislacionit nacional me standardet ndërkombëtarë të garantuara në aktet ndërkombëtare, mirëpo ende ka mungesa në instrumentet ligjore për të mbrojtur të drejtat e fëmijëve në konflikt me ligjin.

Përmbledhja dhe strukturimi i studimit

Në Kapitullin e parë trajtohen aspekti hyrës dhe baza metodologjike të hulumtimit mbi të drejtat e fëmijëve. Të dhënat në këtë kapitull bazohen në informimin e përgjithshëm në lidhje me objektin e studimit ku në fokus të tij janë mbrojtja e të drejtave të fëmijëve dhe marrja e masave ligjore për të minimizuar pjesëmarrjen e fëmijëve në strukturat kriminale. Në këtë kapitull trajtohet rëndësia e studimit, kufizimet e tij, pyetjet kërkimore dhe hipotezën kryesore mbi të cilën është ngritur ky studim. Themelet e studimit janë mbështetur tek metodologjia dhe llojet e metodave mbi të cilat është zhvilluar studimi. Respektivisht në këtë kapitull do të bëhet përkufizimi i termit fëmijë, si dhe kategorizimi i fëmijëve në grupe të ndryshme sipas Ligjit për Drejtsinë e fëmijëve të Republikës së Maqedonisë Veriore, cilat janë kushtet për ngritjen e procedurave penale ndaj këtyre fëmijëve, dispozitat e përgjithshme, procedurat përgatitore si dhe procedurat para këshillit për fëmijë, si dhe do të cekën edhe burimet e ndryshme nacionale dhe ndërkombëtare të së drejtës penale për fëmijë.

Në Kapitullin e dytë trajtohen aspektet procedurale në proceset me fëmijë duke analizuar aspektet procedurale që ofrojnë mbrojtje ndaj fëmijëve si ndalimi/arrestimi i fëmijëve, trajtimi në rastet e paraburgimit të fëmijëve, garancitë në procesin gjyqësor ndaj fëmijëve dhe taktikat e marrjes në pyetje të fëmijëve. Në këtë kapitull do të trajtohen dhe sanksionet penale që parashikohen në legjislacionin bashkëkohor për fëmijët subjekt aktiv në krim. Sanksionet që parashikohen ndaj fëmijëve janë dënimi me burgim, dënimi me gjobë dhe masat edukuese. Po kështu, krahas sanksioneve primare legjislacioni ynë parashikon edhe alternativat të dënimit si gjysmëliria, pezullimi i ekzekutimit të vendimit me burgim dhe vënia në provë, qëndrimi në shtëpi, pezullimi i ekzekutimit të dënimit me burgim dhe detyrimi për kryerjen e një pune në interes publik dhe lirimi me kusht.

Në kapitullin e tretë trajtohen instrumentet ndërkombëtare për të drejtat e fëmijëve, veçanërisht për fëmijët në konflikt me ligjin penal. Procedurat e veçanta ndaj fëmijëve në disa vende europiane.

Në kreun e katërt kemi një vështrim krahasues me legjislacionet e disa prej shteteve të rajonit si Kroacia dhe Republika e Shqipërisë. Në këtë kapitull trajtohen në mënyrë krahasimore parashikimet për drejtësinë e fëmijëve në legjislacionin kroat dhe të shqipërisë duke marrë parasysh aspektet innovative dhe moderne të këtyre legjislacioneve.

Pas vështrimit analitik të problematikave, kemi nxjerrë konkluzionet dhe disa rekomandime të cilat mund të çojnë në përmirësimin e legjislacionit për fëmijë në konflikt me ligjin penal dhe të ecurisë së zbatimit të tij.

KAPITULLI I

Përkufizimi i nocionit fëmijë dhe kategorizimi i fëmijëve në grupe të ndryshme sipas Ligjit për drejtësinë e fëmijëve

1.1 Dispozita të përgjithshme dhe parime lidhur me procedurën për fëmijë

Zhvillimi i kriminalitetit të fëmijëve ka ardhur si një trend në rritje, kjo si pasojë e përfshirjes të fëmijëve në organizata të ndryshme kriminale me qëllim shfrytëzimin e tyre në veprimtari kriminale. Shfrytëzimi i fëmijëve për veprimtari të ndryshme kriminale ka sjellë në vëmendje emergjente krijimin e një legjislacioni të përshtatshëm për luftimin dhe parandalimin e këtij fenomeni. Të drejtat e fëmijëve dhe konfliktet e tyre me ligjin nuk janë fenomene aktuale. Ato kanë ekzistuar që në fazat embrionale të hartimit të legjislacioneve dhe në varësi të periudhave dhe të nevojave të momentit ato kanë pësuar ndryshime pozitive. (Mucchielli, 2010, f. 1) (marrë nga Gjolena, A. 2017, f. 25)

“Fëmijët kanë pasur një pozitë juridiko - penale më të lehtë dhe më të favorshme në krahasim me të rriturit për faktin se fëmijët nuk kanë arritur pjekurinë e duhur biopsikike” (Salihu, 2005, f. 423) Kështu, në të drejtën romake përgjegjësia penale e fëmijëve ndahej në tre kategori.

1. Kategoria e parë është infantil ku bënin pjesë fëmijët që nuk kishin përgjegjësi penale
2. Kategoria e dytë është infantiae proximus ku bënin pjesë fëmijët afër fëmijërisë, dhe këta nuk kishin përgjegjësi penale
3. Kategoria e tretë është ajo e pubertati proximus bënin pjesë fëmijët të cilët ishin afër moshës për përgjegjësi penale (Xhafo ,2012, f. 9).

Pra, në të drejtën romake fëmijët deri në moshën shtatë vjeçare janë konsideruar penalisht të papërgjegjshëm. Kjo për faktin se në këtë moshë fëmija nuk ka arritur ende pjekurinë mendore dhe fizike dhe nuk mund të kuptojë pasojat e shkaktuara nga vepra penale e kryer. (Hajdari, 2002, f. 38). Përgjegjësi penale kishin personat që kanë arritur pjekurinë mendore dhe fizike, kur kanë mundur të kuptojnë rëndësinë e pasojës së ardhur nga vepra penale që ai ka kryer. Ligji i Dymbëdhjetë Tabelave parashikonte dënime të posaçme për fëmijët për veprat penale të

vjedhjes dhe dëmtimit të produkteve bujqësore. Dënimet për këto vepra penale ishin sipas vlerësimit të gjykatësit, rrahja ose kompensimi i dëmit. (Kombovski, 2006, f. 1085).

“Fëmijë është çdo person deri në moshën 18 vjeçare” (neni 12 Ligji mbi Drejtësinë për fëmijë i Republikës së Maqedonisë Veriore, 2013)

Rëndësia që ka përgjegjësia penale e fëmijëve për të përcaktuar raportet e tyre me drejtësinë penale doli në pah dhe u evidentua në kontekstin e duhur vetëm në shekullin e 18-të dhe shekullin e 19-të. Gjatë kësaj periudhe kishte një tendencë në rritje të mendimeve juridike që e konsideronin ndëshkimin moralisht të gabuar dhe një masë edukimi jo efektive. (Leskovik, 2010, f. 9) Në këtë periudhë mund të themi që shoqëria mori formën e duhur ligjore dhe pësoi një zhvillim shoqëror të konsiderueshëm, i cili u shoqërua me rritje të përgjegjshmërisë mbi veprat penale të kryera nga fëmijët.

Klasifikimi i fëmijëve delikuent- Fëmijët delikuent klasifikohen në disa grupe. Disa vende në ligjet pozitive i përcaktojnë kategoritë e moshave dhe rregullojnë një varg çështjesh rreth përgjegjesisë së tyre penale, rreth aplikimit të masave të ndryshme e sidomos masave edukativo-përmirsuese. Si kufi më i ulët i moshës së fëmijëve dhe cilësimit të tyre si kryerës të veprës kriminale, në disa shtete të botës bashkëkohore merret mosha 7 vjeçare, si: Burma, Egjypti, India, Iraku, ndërkaq mosha 9 vjeçare si moshë e përgjegjesisë penale më të ulët merret në Izrael, Jordan, Filipine etj. Mosha 10 vjeçare konsiderohet si moshë e përgjegjesisë penale në Bolivi, Paraguaj, dhe në disa vende tjera të Amerikës Latine. Turqia dhe Irani, si moshë dhe kufi më të ulët e marrin moshën 11 vjeçare. Greqia, Panamaja dhe disa vende të tjera moshën 12 vjeçare, ndërsa Franca dhe Polonia moshën 13 vjeçare. Nga ana tjetër, Zvicra, Danimarka, Suedia, si moshë më të ulët e marrin moshën 15 vjeçare, ndërsa Finlanda dhe Kili, si moshë më të ulët të përgjegjesisë penale ndaj fëmijëve, e marrin moshën 16 vjeçare. (Halili, R. 2007, f. 225)

Republika e Maqedonisë Veriore hyn në kategorinë e shteteve që si shumë shtete tjera të Evropës, si moshë më të ulët ta përcaktojë moshën 14 vjeçare, ndërkaq, si moshë më të lartë ka marrë moshën 18 vjeçare. (Zejneli, I. 2010, f. 25)

Në Republikën e Maqedonisë Veriore, si fëmijë për sa i përket pozitës juridiko- penale, llogariten personat prej moshës 14-18 vjeçare, ndërkaq, personat nën moshën 14 vjeçare llogariten fëmijë dhe janë penalisht të pa përgjegjshëm.

Fëmijë penalisht përgjegjës ndahen në fëmijë të rinjë (prej moshës 14-16 vjec) dhe fëmijë më të vjetër (prej 16-18 vjeç)

Fëmijëve të rinjë për kryerjen e veprave penale gjykata mund t'u shqiptojë vetëm masa edukuese, kurse për kryerjen e veprave penale për të cilat në Kodin Penal të Republikës së Maqedonisë Veriore është paraparë dënimi me burgim mbi 5 vjet, dhe dënimi burgu për fëmijë. (Po aty, f.25)

Fëmijët që kanë kryer vepër penale në moshë prej 14 deri 16 vjet (fëmijë i ri), mund ti shqiptohet vetëm masa edukuese (neni 72, par. 1 i KPM-së) (Po aty, f. 26)

Kriminaliteti si dukuri - Deklarata Univerzale për të drejtat e njeriut e vitit 1948, Konventat mbi të drejtat e fëmijëve, Paktet ndërkombëtare mbi të drejtat e njeriut, Deklaratat dhe konventat tjera mbi të drejtat e njeriut dhe posaçërisht mbi të drejtat e fëmijëve, tregojnë nevojën e madhe që duhet t'i kushtohet fëmijëve. (Zejneli, I. 2010, f. 9) Edhe përkundër masave të shumta që janë duke u ndërmarrë nga ana e institucioneve kompetente për evitimin e shkaqeve të delikuencës së fëmijëve akoma masat parandaluese në këtë drejtim janë të pamjaftueshme. (Po aty, f. 10)

Mendohet se shkaqet e delikuencës së fëmijëve janë të ngjajshme me shkaqet e delikuencës së të rriturve, mirëpo në literaturë theksohen disa faktorë që deri diku janë më tipik për këtë moshë të delikuentëve. Kështuqë, posaçërisht si faktorë përmenden: “ambienti familjar, edukata familjare, familja deficiente, kushtet ekonomike, ndikimi i dëmshëm i rrugës, lëvizjet e popullatës fshat-qytet, migrimi, procesi i edukimit dhe arsimimit, ndikimi i mjeteve të komunikimit masiv sidomos ndikimi i shtypit revial, televizionit, filmit dhe literaturës”.(Zejneli I. 2010, f.14)

Gjatë tërë historisë së njerëzimit, kjo kategori e kryerësve të veprave penale në të drejtën penale ka pasur trajtim të posaçëm, është trajtuar ndryshe nga personat e rritur, një trajtim më të butë dhe më të privilegjuar. (Zejneli, I. 2010, f. 14)

Roma shquhej për lloje të shumta të dënimeve nga të cilat shumë prej tyre kishin për qëllim që ti shkaktonin fajtorit vuajtje fizike, mirëpo, kur ishte fjala për kategorinë e fëmijëve kishte një ndarje klasike sipas moshës: a) në “infantes” gjer në moshën 7 vjeçare dhe ishin të padënueshëm, b) në “inpuberes” deri në moshën 14 vjeçare që dënoheshin vetëm nëse kanë qenë “dolicapaces” pra të zhvilluar mendërisht dhe shpirtërisht. Nëse fëmijë të kësaj moshe kanë kryer vepër penale,

atëherë sipas të drejtës romake, hetimi i përgjegjesisë penale është bazuar në vërejtjen dhe vlersimin e aftësive të tija intelektuale (intellectus rei). (Zejneli, I. 2010, f. 14)

Delikuenca e fëmijëve është më e vogël në krahasim me kriminalitetin e të rriturve.

Kështu p.sh., sipas Kraiserit fëmijët më së shumti kryejnë vepra penale kundër pasurisë dhe vepra penale të delikuentëve në trafikun rrugorë. Megjithatë, vjedhjet edhe pse të imta, lëndimet trupore, ofendimet, prishja e rendit shtëpiak, dhunimet, dëmtimet e sendeve dhe para së gjithash narkodilerët, tregojnë një shkallë të lartë të rritjes. (Po aty, f. 15)

1.2 Kushtet për iniciimin e procedurës ndaj fëmijëve kryerës të veprave penale

Koncepti kryesor dhe vendimtar në shkollën sociologjike është se faktori dominant në sjelljet e këtilla të fëmijëve gjendet jo vetëm në faktorin endogjen biopsiik por, edhe në faktorin shoqëror. Sipas kësaj, rëndësi të posaçme në shfaqjen e veprave penale nga ana e fëmijëve kanë faktorët e jashtëm veçanërisht faktorët shoqëror dhe rrethanat e tjera në të cilat kryerësi i veprave penale jeton dhe vepron. (Zejneli, I. 2010, f. 21)

Disa nga këto faktorë padyshim janë: kushtet ekonomike, kushtet e jetës apo siç i quajnë disa autorë kushtet banesore, kushtet familjare, mungesa e kontrollit të duhur nga ana e prindërve, përfshirja e fëmijëve në grupe të ndryshme, etj. (Po aty, f.21)

Format e paraqitjes së delikuencës së fëmijëve, nëse e shikojmë fenomenologjinë e sjelljeve delikuede të fëmijëve, vërrehet se ajo konsiston në ndërmarrjen e veprimeve dhe aktiviteteve të ndryshme që pak a shumë janë të ngjajshme me kriminalitetin e personave të rritur, por kuptohet se në raste konkrete ka edhe disa veçori të theksuara, kështuqë nga të dhënat e kërkimeve kriminologjike dhe nga praktika gjyqsore vërehet se delikuentët fëmijë dukshëm marrin pjesë në kriminalitetin kundër pasurisë, në kriminalitetin e trafikut, në kryerjen e veprimeve në grupe dhe shoqata të ndryshme kriminale, në aktivitetin rreth shpërndarjes dhe konsumimit të drogës, në veprime tjera të dhunës, e sidomos në krimet kundër jetës dhe trupit dhe në deliktet seksuale. (Zejneli, I. f. 36)

“Nga të dhënat statistikore që kanë të bëjnë me kryerjen e veprave penale nga ana e të miturve rezulton që gjatë periudhës kohore prej vitit 2017 deri në vitin 2019 janë kryer 1657 vepra penale

të paraqitura prej të cilave jo të gjithë të miturit kanë rezultuar të jenë të gjykuar apo të akuzuar për veprat penale në fjalë.”(Po aty)

1.3 Procedura përgatitore

Në vijim do të theksohen disa nene të Ligjit për drejtësinë e fëmijëve të vlerësuara si më të rëndësishme për analizën e mëtejshme të të drejtave të fëmijëve të përfshirë në vepra penale.

- (1) Ligji përcakton se me dispozitat e tij rregullohen veprimi me fëmijët delikuent dhe kushtet për shqiptimin e sanksioneve penale dhe masave të tjera preventive nga ana e organeve kompetente.
- (2) Me këtë ligj rregullohen masat për mbrojtjen e fëmijëve viktime të veprave, që me ligj janë paraparë si vepra penale, dhe të fëmijëve dëshmitarë, dhe masat për preventivën e delikuencës së të fëmijëve. (Neni1)

Qëllimet e ligjit dhe të zbatimit të tij janë realizimi i interesit prioritar dhe mbrojtja e fëmijëve nga kriminaliteti, dhuna dhe nga cilado formë e rrezikimit të lirive dhe të drejtave të tyre dhe zhvillimit të tyre të drejtë, mbrojtja e fëmijëve kryerës të veprave të cilat me ligj janë paraparë si vepra penale dhe kundërvajtje dhe nga përsëritja e atyre veprave, socializimi i tyre, edukimi dhe riedukimi, ndihma dhe kujdesi për fëmijët dhe mbrojtja në procedurë para gjykatës dhe organeve tjera, të lirive dhe të drejtave të tyre të garantuara me Kushtetutën e Republikës së Maqedonisë, me Konventën për të drejtat e fëmijës dhe me marrëveshjet tjera ndërkombëtare për pozitën e fëmijëve, të ratifikuara në pajtim me Kushtetutën e Republikës së Maqedonisë. (Neni 2)

1.4 Qëllimi i aplikimit të procedurave të veçanta ndaj fëmijëve

Në Konventën për të drejtat e fëmijëve gjejmë një përkufizim ligjor të termit fëmijë. Kështu, në nenin 1 të Konventës përcaktohet se “Me fëmijë kuptohet çdo qenie njerëzore nën moshën 18 vjeç, me përjashtim të rasteve kur mosha madhore arrihet më përpara”. Nga interpretimi i këtij neni mund të kuptojmë që nga mosha e përcaktuar nga Konventa mund të ketë edhe përjashtime ligjore të përcaktuara nga legjislacionet kombëtare. Një person në moshën tetëmbëdhjetë vjeç gëzon të drejtën aktive dhe pasive të votimit, ka të drejtë të lidhë martesë, kontrata etj.

(Unicef,2010, f.28). Fëmijët deri në moshën katërbëdhjetë vjeç janë të përjashtuar nga sanksionet penale si dënime dhe çdo lloj mase edukuese. (Hajdari, 2002, f. 18)

Krimet tek fëmijët janë shqetësuese për çdo shoqëri, kjo sepse sa më shumë të inkriminuar të ketë në radhët e fëmijëve, aq më e errët bëhet perspektiva e shoqërisë njerëzore. Ky është dhe shkakun që krimeve të fëmijëve u kushtohet një vëmendje e veçantë dhe kriminologjia është e interesuar edhe për këtë pjesë të veprimeve dhe të sjelljeve kriminale. (Gjoncaj, 2014, f. 96)

Aktualisht llojet e veprave penale në të cilat gjejmë të përfshirë edhe fëmijë janë pengmarrja, pjesëmarrja në krimin e organizuar, qarkullimi i lëndëve narkotike, mashtrimet valutore, tregtia e armëve, krimet kompjuterike etj. (Gjoncaj, 2014, f. 95) Kjo tregon për rrezikshmërinë e veprave penale të kryera prej tyre.

Me Ligjin për Drejtësinë e fëmijëve të Republikës së Maqedonisë Veriore për zbatimin e të cilit janë prioritar mbrojtja e fëmijëve nga kriminaliteti, dhuna dhe nga cilado formë e rrezikimit të lirive dhe të drejtave të tyre dhe zhvillimit të tyre të drejtë, mbrojtja e fëmijëve kryerës të veprave të cilat me ligj janë të parapara si vepra penale dhe kundërvajtje, dhe nga përsëritja e atyre veprave, socializimi i tyre, edukimi dhe riedukimi, ndihma dhe kujdesi për fëmijët dhe mbrojtja në procedurë para gjykatës dhe organeve tjera, të lirive dhe të drejtave të tyre të garantuara me Kushtetutën e Republikës së Maqedonisë Veriore, me Konventën për të drejtat e fëmijës dhe me marrëveshje të tjera ndërkombëtare për pozitën e fëmijëve, të ratifikuara në pajtim me Kushtetutën e RMV. (LDF, 2013, neni 2)

1.5 Burimet e të drejtës penale për fëmijë në RMV

1.5.1. Burimet nacionale të të drejtës penale për fëmijë

Në literaturën kriminologjike dhe juridiko - penale hasim një numër bukur të madh të përkufizimeve të kuptimit të delikuencës së fëmijëve.

Prej të gjitha kuptimeve që i kemi hasur, si në literaturën sociologjike, kriminologjike dhe atë juridike, në kuptimin më të gjërë përdoret nocioni delikuencë e fëmijëve ose sjellje delikente e të rinjëve.

Masat edukuese të kontrollit të shtuar të fëmijëve i përgjigjet shpesh edhe shprehjes sjellje kundërvajtëse, shprehje të cilën e hasim në një pjesë më të madhe të literaturës. Mirëpo,

delikuenca e fëmijëve përfshin edhe kriminalitetin, kundërvajtjet si dhe sjelljet tjera devijante dhe negative të fëmijëve.

Në literaturë mendohet se ligji i parë mbi delikuencën e fëmijëve është sjellur në SHBA në shtetin e Illinois (v. 1899), ku më pas pësoi nxjerrja e ligjeve të posaçme edhe në shtetet tjera.

Sipas Kodit Penal të Republikës së Maqedonisë Veriore fëmijë konsiderohen personat prej moshës 14 deri në moshën 18 vjeçare, me një nënndarje persona fëmijë të rinjë prej moshës 14-16 vjet dhe fëmijë të ritur prej moshës 16-18 vjet. (Zejneli, I. 2010, f. 19)

Tabela nr. 1 Numri i përgjithshëm i fëmijëve të paraqitur, të akuzuar dhe të dënuar gjatë intervalit kohorë nga viti 2017 deri më vitin 2019 në RMV

Viti	2017			2018			2019		
	Të paraqitur	Të akuzuar	Të gjykuar	Të paraqitur	Të akuzuar	Të gjykuar	Të paraqitur	Të akuzuar	Të gjykuar
Gjithsej	578	554	368	554	403	330	525	470	304

Burimi: Enti statistikor i Republikës së Maqedonisë Veriore³ www.stat.gov.mk

Nga të dhënat statistikore rezulton se numri më i madh i fëmijëve të paraqitur për kryerjen e veprave penale është gjatë vitit 2017 në krahasim me dy vitet tjera, e njejtja gjendje paraqitet edhe me numrin e fëmijëve të akuzuar e cila rezulton të jetë më e lartë gjatë vitit 2017 sesa dy vitet e tjera, poashtu edhe numri i të gjykuarve qëndron më i lartë gjatë të njejtit vit. Nga këto të dhëna mund të shohim se në vitet në vazhdim është zvogluar numri i fëmijëve që kanë kryer vepra penale në një masë të vogël mirëpo përsëri shumë domethënëse.

1.5.2 Burimet ndërkombëtare të të drejtës penale për fëmijë

Mbrojtja e fëmijëve nga fenomeni i kriminalitetit dhe hartimi i masave parandaluese të cilat do të minimizonin pjesëmarrjen e tyre në kriminalitet përbën një sfidë për legjislacionin tonë por edhe për gjithë shoqëritë bashkëkohore. Megjithatë, legjislacioni i vendit tonë është në harmoni dhe i përqsur me standardet ndërkombëtare lidhur me drejtësinë për fëmijët. Shteti ynë ka ratifikuar një mori Konventash ndërkombëtare që lidhen me të drejtat e njeriut në përgjithësi

³ Mëtej Enti Statistikor I Republikës së Maqedonisë Veriore do të haset si www.stat.gov.mk

dhe të fëmijëve në veçanti. Këto instrumente ndërkombëtare ku aderën edhe Republika e Maqedonisë Veriore edhe Shqipëria, janë një pikë referimi për ndërtimin e një sistemi ligjor efikas. Autorja Gjolena vlerëson se aktet ndërkombëtare ku bën pjesë dhe vendi ynë, janë parashikuar një harmoni me një sërë norma juridike mbi mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve nga “në sfera të ndryshme të jetës dhe në marrëdhënie të ndryshme ku ata janë të përfshirë, qoftë në të drejtën penale, familjare, civile, të punës etj”. (Gjolena, A. 2017, f. 45)

Instrumentet ndërkombëtarë që trajtojnë të drejtat e fëmijëve klasifikohen në:

1. Instrumente ndërkombëtare të OKB-së
2. Instrumente të Këshillit të Evropës
3. Instrumente të Bashkimit Europian.

Dokumentet ndërkombëtarë që trajtojnë pozitën juridike të fëmijëve në raport me ligjin penal janë: Deklarata Universale e të Drejtave të Njeriut, Konventa mbi të Drejtat e Fëmijës e New York-ut miratuar në 20.11.1989 dhe protokollat e saj shtesë si dhe Konventa Kundër Torturës dhe Vuajtjeve të tjera ose trajtimit mizor, çnjerëzor apo degradues ratifikuar me ligjin nr. 7727 datë 30.6.1993, Rregullat standard minimum të Kombeve të Bashkuara për administrimin e drejtësisë për fëmijë (1985), Rregullat e Kombeve të Bashkuara për mbrojtjen e të rinjve të cilëve u është hequr liria (Rregullat e Havanës 1990), Rregullat Standard Minimum të Kombeve të Bashkuara lidhur me masat e mos-arrestimit (Rregullat e Tokios 1990), Udhëzimet e Kombeve të Bashkuara për parandalimin e kriminalitetit të të rinjve (Udhëzimet e Riadit 1990).

Deklarata në nenin 1 e thekson se “qëniet njerëzore kanë lindur të lirë dhe të barabartë me dinjitet dhe me të drejta” duke i dhënë kështu një rëndësi dhe dimension univerzal konceptit të lirisë dhe barazisë të të drejtave të njeriut.

Kuadri ligjor i Konventës ka një qasje të thelluar në drejtim të mbrojtjes së të drejtave të fëmijëve. (Save the Children, Raporti Vjetor, 2012, f. 29).” Mesazhi social që përcjell ky akt është i fortë dhe e trajton fëmijën si një qenie në zhvillim e sipër, me mundësi për t’u rehabilituar dhe terapitë që sistemi do të përdorë për “shërim” duhet të jenë të ndryshme dhe të veçanta prej atyre të të rriturve. Mbrojtja e veçantë e fëmijëve dhe mirëqenia e tyre janë esenciale në një shoqëri demokratike, sepse standardet sociale të së ardhmes varen nga ndërgjegjësimi dhe edukimi, mbrojtja dhe arsimimi i fëmijëve sot”. (UNICEF 2010, 16, cituar tek Gjolena, A. 2017, f. 50)

Neni 39 i Konventës proklamon të drejtën e rehabilitimit dhe riintegrit social të fëmijëve që janë viktimë të pakujdesisë, shfrytëzimit dhe keqtrajtimit. Konventa mbulon në mënyrë më specifike të gjitha të drejtat e të gjithë fëmijëve të akuzuar për shkelje të legjislacionit.

“Rregullat standard minimum të Kombeve të Bashkuara për administrimin e drejtësisë për fëmijë (Rregullat e Pekinit) - Rregullat standarde minimum të Kombeve të Bashkuara për administrimin e drejtësisë për fëmijë janë miratuar nga Asambleja e Përgjithshme e OKB-së dhe kanë si qëllim kryesor që të sigurojnë minimizimin e efekteve negative e të dëmshme në trajtimin e fëmijëve nga hallkat e sistemit të drejtësisë duke parandaluar shtimin e kriminalitetit dhe duke e përsosur sistemin e drejtësisë për fëmijë në nivel kombëtar”. (Leskovit, 2010, f. 15) Rregullat e Pekinit theksojnë që sistemi i drejtësisë të fokusohet në mirëqenien e fëmijëve dhe të sigurojë se çdo reagim ndaj shkelësve të ligjit që janë fëmijë duhet të jetë në përpjesëtim me rrethanat e shkeljes dhe autorit të shkeljes. Gjithashtu këto rregulla theksojnë se përpjekjet e shumta për të vendosur në çdo legjislacion kombëtar disa ligje, rregulla dhe dispozita të aplikueshme në mënyrë të veçantë për fëmijë dhe institucione të caktuara për funksionimin e administrimit të drejtësisë për fëmijë. (Save the Children, Raporti Vjetor, 2012, f. 15)

Udhëzimet e Kombeve të Bashkuara për parandalimin e kriminalitetit të të rinjve (Udhëzimet e Riadit 1990) - Udhëzimet e Riadit fokusohen tek parandalimi i kriminalitetit tek fëmijët duke u bazuar tek disa nga parimet themelore si parandalimi i kriminalitetit të fëmijëve nëpërmjet përfshirjes së tyre në aktivitete të ligjshme e të dobishme, parandalimi i kriminalitetit tek fëmijë kërkon përpjekje nga e gjithë shoqëria për të siguruar zhvillimin harmonik të fëmijëve duke respektuar personalitetin e tyre.

Në interpretim të Udhëzimeve të Riadit në sistemet e brendshme kombëtare ndiqet politika e vendosjes së fëmijës në fokus të vëmendjes ligjore dhe shoqërore. Të rinjtë duhet të kenë një rol aktiv në gjirin e shoqërisë. Në zbatim të këtyre Udhëzimeve sistemet kombëtare duhet të kenë në fokus programet parandaluese për kriminalitetin e fëmijëve. Detyrimin e shteteve që të njohin nevojat dhe rëndësinë e politikave të parandalimit progresiv të kriminalitetit tek fëmijët, duke shmangur inkriminimin dhe penalizimin e fëmijës për sjellje që nuk sjellin dëme të rëndësishme për shoqërinë. Këto politika duhet të përfshijnë veçanërisht:

- a. sigurimin e nevojave edukative të fëmijëve që shërbejnë si një kuadër mbështetës në zhvillimin e personalitetit të fëmijëve veçanërisht të atyre që janë të ekspozuar ndaj rrezikut dhe kanë nevojë për përkujdesje e mbështetje të veçantë.
- b. Mënyra të veçanta dhe afatgjata për parandalimin e kriminalitetit tek fëmijët bazuar në ligje të posaçme të mbështetura nga institucione të specializuara me qëllim reduktimin e nevojave apo situatave që çojnë fëmijët drejt kriminalitetit.
- c. Ruajtjen e mirëqenies, të drejtave dhe interesave të fëmijëve.
- d. Faktin që njeriu është qenie në evoluim të përhershëm dhe që zakonisht sjelljet antagoniste zhduken tek fëmijët me kalimin e moshës.
- e. Ndërgjegjësimi i opinionit që jo gjithmonë përcaktimi i të rinjve si devijantë duhet të bëhet nisur nga një karakteristikë e padëshirueshme e sjelljes së tyre.
- f. Futjen e shërbimeve të bazuara në komunitet për parandalimin e kriminalitetit të fëmijëve veçanërisht aty ku mungojnë agjensitë mbështetëse.

Një ndihmesë e madhe janë edhe fondet e mjaftueshme që duhet të sigurohen për shërbimet shëndetësore, ushqimin, strehimin, këshillimin dhe parandalimin e abuzimit.

Konventa Europiane mbi ushtrimin e të Drejtave të Fëmijëve, Strazburg, 1996 (Këshilli Europian) Këshilli i Europës duke qenë se kishte si synim mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave dhe interesave më të mira të fëmijëve miratoi në 25 janar të vitit 1996 Konventën Europiane mbi ushtrimin e të drejtave të fëmijëve. Fusha e veprimit dhe objekti i konventës ishte te fëmijët që nuk kanë mbushur moshën 18 vjeç. Objekti i Konventës përcaktohet në nenin 1 paragrafi 2 ku më konkretisht thuhet se “Objekti i kësaj konvente është, në interesat më të mira të fëmijëve, që të promovojë të drejtat e tyre, t’u japë atyre të drejta procedurale dhe të lehtësojë ushtrimin e këtyre të drejtave, duke siguruar që fëmijët, vetë ose nëpërmjet personave ose organeve të tjera, të informohen dhe të lejohen për të marrë pjesë në procedime që ndikojnë tek ata para një autoriteti gjyqësor” Konventa proklamon të drejtën për t’u informuar dhe për të shprehur pikëpamjet e tij ose të saj në procedim. Kështu, në nenin 3 të saj përcaktohet se “Një fëmijë, që sipas ligjit të brendshëm konsiderohet se ka arsyetim të mjaftueshëm, në rast të procedimeve para një autoriteti gjyqësor që ndikojnë tek ai/ajo, i jepet dhe ka të drejtë të kërkojë të drejtat e mëposhtme: a) të marrë të gjithë informacionin përkatës; b) të konsultohet dhe të shprehë

pikëpamjet e tij ose të saj; c) të informohet për pasojat e mundshme të përputhshmërisë me këto pikëpamje dhe pasojat e mundshme të çdo vendimi.” (European Convention on the Exercise of Children's Rights 1996, cituar tek Gjolena, A. 2017)

KAPITULLI II

Procedurat e veçanta ndaj fëmijëve

2.1. Procedura për ndërmjetësim

Ligji i drejtësisë për fëmijët e autorizon Qendrën për punë sociale që të mund ta zhvillojë procedurën e ndërmjetsimit mes fëmijës në rrezik dhe përfaqësuesit të tij ligjor dhe të dëmtuarit/viktimës në raste të përcaktuara me ligj për veprë penale, nga e cila fëmija në rrezik ka përfituar dobi pronësore ose i ka shkaktuar dëm tjetrit.

Qëllimi i zhvillimit të kësaj procedure është arritja e pajtimit të palëve dhe premtimi nga ana e fëmijës se nuk do të përsëritet vepra, dhe për kthimin e dobisë pronësore ose për kompensimin e dëmit të shkaktuar. Procedura e ndërmjetsimit mund të zgjasë më së shumti 30 ditë pas miratimit të vendimit për zhvillimin e saj.

Ligji i drejtësisë për fëmijë i rregullon kushtet për ndërmjetsimin në mes fëmijës dhe palës së dëmtuar. Në këtë rast pas pranimit të kallximit penal për veprë penale për të cilën parashihet dënimi me burg deri në pesë vite, prokurori publik kompetent autorizohet t'i informojë fëmijën dhe përfaqësuesin e tij ligjorë, mbrojtësin dhe të dëmtuarin dhe të kërkojë nga fëmija dhënie të pëlqimit për zhvillimin e procedurës së ndërmjetsimit. Pas pranimit të pëlqimit të dhënë me shkrim të fëmijës, ai i udhëzon palët për zhvillimin e procedurës së ndërmjetsimit.

Afati për përfundimin e procedurës së ndërmjetsimit është i përcaktuar me LDF-në, i cili parashihet të zgjasë më së shumti deri në 45 ditë nga dita e dorzimit të pëlqimit me shkrim të organit kompetent. Nëse mbrenda këtij afati nuk kryhet procedura e ndërmjetsimit, lënda kthehet tek prokurori publik, ose procedura gjyqësore do të vazhdojë aty ku është ndërprerë. (Ahmedi, B., f. 162). Përfundimi i ndërmjetsimit përfundon në këto raste të përcaktuara me LDF-në.

“Me lidhjen e marrveshjes me shkrim nga ana e ndërmjetsuesit dhe palëve për pëlqimin e arritur për kompensimin e dëmit material dhe jomaterial, me deklaratën me shkrim të ndërmjetsuesit, pas konsultimeve me palët se nuk janë të arsyeshme tentimet e mëtejshme për ndërmjetsim, deri në ditën e parashtrimit të deklaratës dhe me skadimin e afatit të paraparë për përfundimin e procedurës së ndërmjetsimit” (Po aty). Palët mund që në çfardo kohe të heqin dorë nga

procedura e ndërmjetsimit pa i theksuar me këtë rast shkaqet për këtë. Heqja dorë do të konsiderohet nga dita e parashtrimit të deklaratës për dorëheqje.

2.2 Karakteristikat e procedurës ndaj fëmijëve

Ligji i drejtësisë për fëmijët rregullon veprimin ndaj fëmijëve dhe në forma të tjera krahas procedurës së rregullt penale. Dispozitat e këtij ligji parashohin mundësinë e zbatimit të disa procedurave të veçanta të cilat përmbajnë në vetvete elemente të drejtësisë restorative, një tendencë që po merr përparsi dhe e cila është marrë si model nga shtetet evropiane që e zbatojnë më shumë këtë formë të qasjes ndaj veprimit me fëmijët shkelës të ligjit.

Lidhur me paraburgimin për fëmijë, veçanërisht e rëndësishme është dispozita e Ligjit për Gjykatat për fëmijë, i cili përcakton që gjyqtari për fëmijë duhet të njoftojë menjëherë prindërit, kujdestarët ose institucionet të cilëve u është besuar kujdesi për fëmijën, si dhe qendra e mirëqenies sociale për ndalimin e fëmijëve (neni 73 i LGJM).

Masat alternative ndaj ndalimit

Masat alternative ndaj ndalimit, siç u diskutua më lart, kanë përparësi ndaj ndalimit. Këto janë masa paraprake nga neni 90 i ligjit të procedurës penale dhe masa e përkohshme nga neni 72 i ligjit për gjykatat për fëmijë.

a) Masat paraprake (neni 90 i Aktit të Procedurës Penale)

- Ndalimi i largimit nga një vendbanim;

- Ndalimi i vizitës në vende ose territore të caktuara;
- Detyrimi i një fëmije për të raportuar në mënyrë periodike tek një person ose autoritet specifik;
- Ndalimi i takimit me persona të caktuar ose ndalimi i çdo lloj kontakti me këta persona;
- Ndalimi i përfshirjes në aktivitete të caktuara afariste;
- Sekuestrimi i përkohshëm i udhëtimit dhe dokumenteve të tjera për kalimin e kufirit shtetëror;
- Marrja e përkohshme e lejes së drejtimit.

Në rast se ekzistojnë rrethana që përbëjnë bazën e ndalimit, gjykata, nëse i njëjti qëllim mund të arrihet me ndonjë nga masat e parashikuara nga ligji, nxjerr një vendim me një arsyetim që urdhëron një fëmijë të kryejë një ose më shumë nga masat. Një fëmijë i tillë do të paralajmërohet që në rast të moszbatimit të masës së urdhëruar, ajo masë mund të zëvendësohet me një masë tjetër paraprake, me një masë më të ashpër, ose me paraburgim.

b) Masat e Përkohshme (Neni 72 i Ligjit për Gjykatat për fëmijë)

- Vendosja e përkohshme e një fëmije, gjatë procedurave paragyqësore, nën mbikëqyrjen e një qendre të mirëqenies sociale për të marrë ndihmë dhe mbrojtje,
- Vendosja e përkohshme e një fëmije në një institucion të mirëqenies sociale.

Gjyqtari për fëmijë mund të urdhërojë këto masa vetëm ose me rekomandim të prokurorit publik. Gjyqtari për fëmijë mund të nxjerrë një vendim të tillë kur është e përshtatshme në lidhje me sanksionin e pritur, në mënyrë që të mbrojë fëmijën nga rrezikimi i mëtejshëm i zhvillimit të tij ose të saj, veçanërisht përmes sjelljeve të mëtejshme kriminale.

Qendra e mirëqenies sociale e caktuar në zonën e vendbanimit të përhershëm të fëmijës kryen të dy masat e përkohshme.

Një tendencë që favorizon dekriminalizimin e drejtësisë për fëmijë nuk ekziston në Republikën e Kroacisë. Sidoqoftë, tendenca mbizotëruese si në legjislaturë ashtu edhe në praktikë është që të zgjidhen sa më shumë çështje të jetë e mundur bazuar në parimin e mundësive në lidhje me vendimin e prokurorit publik për fëmijë që i nënshtrohen procedurave penale.

3.7 Historiku i përgjegjesisë penale ndaj të fëmijëve në Republikën e Shqipërisë

Studimi i kriminalitetit të fëmijëve në Shqipëri, është i fokusuar kryesisht në faktorët psiko-socialë (Beqo dhe Doçi, 2015, f. 2). Për fëmijët e grup moshës të 10-15 vjeç të cilët kishin aftësi mendore për të kuptuar rëndësinë e veprës penale kodi penal përcaktonte këto rregulla:

- a. Në vend të ndëshkimit me vdekje ose me burgim të përjetshëm caktohej burgimi nga gjashtë deri në pesëmbëdhjetë vjet.
- b. Kur ndëshkimi është mbi dymbëdhjetë vjet, jepet dënimi nga tre deri në dhjetë vjet; kur ndëshkimi kalon gjashtë vjet por jo dymbëdhjetë vjet jepej dënimi nga një deri në pesë vjet, në rastet e tjera jepej më pak se gjysma e dënimit e parashikuar.
- c. Dënimet me gjobë zbriteshin me një të tretën
- d. Ndëshkimet me gjobë zbriten në një të dytën
- e. Këto dënime do të kryheshin në institucione për fëmijë

Kodi Penal i mbretërisë për fëmijët e moshës 15-18 vjeç parashikonte dënimet si:

- 1) Në vend të ndëshkimit me vdekje ose me burgim të përjetshëm jepej një dënim me burgim nga dymbëdhjetë deri në njëzet vjet.
- 2) Kur ndëshkimi është mbi dymbëdhjetë vjet, jepet dënimi nga gjashtë deri në dymbëdhjetë; në rast se dënimi i kalon tre vjet por jo dymbëdhjetë vjet jepet dënimi nga tre deri në gjashtë vjet, në rastet e tjera ndëshkimi zbritet deri në gjysmën.
- 3) Ndëshkimeve me gjobë u zbritët një e treta.
- 4) Në rastet e heqjes së lirisë personale fëmijët vendoseshin në institucione përmirësimi. (Kodi Penal neni 56)

Përmbysja e shtetit totalitar, kalimi në pluralizmin politik dhe zhvillimet politike, ekonomike, sociale, kulturore që shoqëruan shoqërinë shqiptare dhe shtetin shqiptar pas viteve '90, u reflektuan në mënyrë të drejtpërdrejtë në qëndrime institucionale të caktuara në lidhje me të drejtat e njeriut në përgjithësi dhe fëmijëve në veçanti. Kështu, pas rënies së regjimit komunist drejtësia shqiptare ishte e papërgatitur për t'u përballur me sfidat e momentit dhe më zhvillimin që kishte marrë kriminaliteti në përgjithësi dhe ai i fëmijëve në veçanti. E gjendur në këto kushte ishte e domosdoshme reformimi rrënjësor i sistemit të drejtësisë penale. Ky reformim duhet të prekte konkretisht legjislacionin penal e procedural penal, organizimin e sistemit gjyqësor, të

prokurorisë, të policisë gjyqësore, avokatisë dhe të institucioneve të vuajtjes së dënimeve (burgjet). (E, Elezi, f. 34)

Kështu, u përcaktua që deri në moshën 14 vjeç të fëmijëve konsiderohen fëmijë, kurse prej moshës 14 deri në moshën 18 vjeç janë penalisht përgjegjës dhe përgjigjen kur veprojnë me vetëdije. (Latifi, 1982, 45)

3.8 Kodi i Drejtësisë Penale për fëmijë i Republikës së Shqipërisë

Ligji nr. 18/2017 Për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijës” është hartuar në përputhje të plotë me KDF, jo vetëm në kontekstin e të drejtave, por edhe të ngritjes së një sistemi mbrojtjeje për realizimin efektiv të tyre.

Ky përcaktim vjen në përputhje me objektivin kryesor të Strategjisë së Reformës në Drejtësi dhe Planit të saj të Veprimit, në të cilin parashikohet: “Reformimi i sistemit të drejtësisë për fëmijët në konflikt me ligjin duke forcuar sistemin e drejtësisë restauruese dhe mbrojtjen efektive të drejtave të tyre procedurale”.

Edhe nëse ka ngjashmëri mes këtyre dy nocioneve, ato nuk mbulojnë saktësisht të njëjtin realitet. Drejtësia restauruese mund të organizohet si në kuadër të një procedure gjyqësore ashtu edhe si një skem shmangie.

Në mënyrë ideale, shmangia duhet të ndodhë në fazat më të hershme të procesimit të drejtësisë për fëmijët për të parandaluar përfshirjen e mëtejshme në sistem. Në nenin 55, pika 3, është përcaktuar një listë me kritere specifike me vërtetimin e të cilave, organi kompetent aplikon automatikisht zbatimin e masës së shmangies. Në çdo rast merret pëlqimi nga fëmija dhe prindi. Kur fëmija nuk ka prindër, ose ekziston një konflikt interesi midis prindërve dhe fëmijës, pëlqimin mund ta japë një prej përfaqësuesve procedural.

Ky program mund të parashikojë që fëmijës t’i kërkohet:

- të kompensojë dëmin e shkaktuar viktimës, komunitetit dhe/ose shoqërisë;
- t’i kërkojë falje viktimës;
- të ndërmarrë veprime të pranueshme edhe nga viktimat ose/dhe komuniteti.
- të marrë pjesë në një procedurë ndërmjetësimi,
- të kryejë punë në interes publik;

- të marrë pjesë në programe rehabilituese ndaj pasojave të veprës penale

Dhënia e pëlqimit duhet të shënohet në procesverbalin e organit procedues. Prokurori mund të marrë pjesë në procesin e ndërmjetësimit nëse ai e vlerëson.

Megjithatë, mekanizmat e shmangies mund të aplikohen në fazat e mëvonshme për të parandaluar futjen e mëtejshme në sistem dhe zgjidhjen e kushtueshme, duke e çuar fëmijën larg shtëpisë së tij. Fëmijët mund të shmangen nga strukturat ligjzbatuese para arrestimit, gjatë procedurave të gjyqimit, ose edhe pas gjyqimit, por para dhënies së vendimit të tij. Në rast se propozimi i prokurorit/gjyqtarit për masë shmangie pranohet nga palët, atëherë vendoset pezullimi i hetimit apo gjyqimit për një afat jo më shumë se 45 ditë.

Zgjidhja me ndërmjetësim ofron një sërë avantazhesh për fëmijën: i) pushon ndjekja penale; ii) pushon hetimi; iii) fëmija konsiderohet i padënuar; iv) sigurohet asgjësimi i të dhënave të gjëndjes penale/gjyqësore; v) sigurohet rehabilitimi dhe rishoqërimi i fëmijës; vi) sigurohet zhdëmtimi i viktimës; vii) përmirësohen marrëdhëniet midis të akuzuarit dhe viktimës.

Megjithatë, alternativat për procedimet gjyqësore të tilla si: ndërmjetësimi, shmangia (e mekanizmave gjyqësore) dhe zgjidhja alternative e mosmarrëveshjeve është e nevojshme të inkurajohet sa herë që këto mund t'i shërbejnë më së miri interesave më të larta të fëmijës. Por përdorimi paraprak i alternativave të tilla nuk duhet të përdoret si një pengesë për aksesin e fëmijës tek drejtësia.

3.9 Qasja shumëdisiplinore në Drejtësinë Miqësore për fëmijë

Shërbimet sociale, arsimore, policia e shtetit, shërbimi i provës dhe prokuroria, mund dhe duhet të bashkëpunojnë jo vetëm në parandalimin, por edhe në rehabilitimin e tyre. Profesionistët e disiplinave të ndryshme që punojnë në sistemin e drejtësisë e kuptojnë që të funksionosh në një mënyrë miqësore me fëmijët, kategorikisht është e nevojshme që të kalohet nga një qasje disiplinore në një qasje ndërdisiplinore, dhe për këtë nevojitet bashkëpunimi mes të gjithë profesionistëve që punojnë në sistemin e drejtësisë. Sa herë që një fëmijë apo adoleshent, qoftë ai/ajo një viktimë, ose në shkelje të ligjit vjen në sistemin e drejtësisë, shumë e rëndësishme është që të ekzistojnë procedura të përshkruara mirë, që zbatohen kur çdo profesionist luan rolin e tij/saj. Mund të bëhet, për shembull, një përpjekje nga gjyqtari që të shmangen vështirësitë e

shtuara psikologjike, duke kufizuar çdo paraqitje personale të viktimës në procedura. Ose, në rast të një fëmije në konflikt me ligjin, punonjësi social i ngarkuar me rastin dhe mësuesit nga shkolla ku shkon i riu mund të punojnë së bashku me gjyqtarin për ta ndihmuar dhe aplikuar nje masë aleternative, e cila krijon mundësinë më të mirë për këtë të ri që të ndjekë shkollimin e tij/saj apo të përfitojë aftësi profesionale, që deri më tani rezultojnë të jenë kundërhelmi më i mirë ndaj recidivizmit.

Gjithashtu, arritjet pozitive realizohen vetëm kur një fëmijë apo adoleshent viktimë vë re që profesionistët e përfshirë në sistemin e drejtësisë e trajtojnë atë me dhimbsuri dhe respekt, i njohin dëmin që i është shkaktuar dhe kërkojnë zgjidhjen më të mirë të mundshme për ta kthyer viktimën në rrugën e një zhvillimi të harmonishëm. E njëjta gjë është e vlefshme edhe për të rinjtë në konflikt me ligjin. Për të siguruar këtë bashkëpunimin shumëdisiplinor, si edhe për të hartuar e zbatuar programe specifike rehabilitimi dhe ri-integrimi për fëmijë në konflikt/kontakt me ligjin, një forum ndërsektorial është ngritur në nivel të qeverisjes qendrore, i cili po kontribon në përgatitjen e akteve nënligjore të nevojshme për bashkëpunimin dhe bashkërendimin e punës së institucioneve në nivel vendor, si edhe për të nxitur vënien në zbatim dhe mbikëqyrur mbarëvajtjen e këtij bashkëpunimi.

KAPITULLI IV

Të dhënat empirike lidhur me procedurat e veçanta ndaj fëmijëve në RMV

4.1 Numri i rasteve të aplikimit të procedurave të veçanta te fëmijët kryerës të veprave penale në RMV

Analizimi i të dhënave statistikore ka një rëndësi të veçantë sepse vetëm kështu ne mund të njohim më mirë natyrën dhe karakterin e veprës penale, mund të përcaktojmë shkallën e rrezikshmërisë shoqërore si të veprave penale po ashtu dhe të personave fëmijë që i kanë kryer këto vepra penale, dhe në këtë mënyrë mund të arrihet një organizim më i mirë kundër veprimtarisë kriminale në përgjithësi dhe të fëmijëve në veçanti. Bazuar në të dhënat statistikore kriminaliteti i fëmijëve është një fenomen në rritje jo vetëm në vendet e zhvilluara por gjithashtu edhe në vendet që gjenden në zhvillim të shpejtë ekonomik dhe në ato të prapambetura. Sipas të dhënave të siguruar nga Enti statistikor i të dhënave i Republikës së Maqedonisë Veriore rezultoni si më poshtë:

Tabela nr. 2 Numri i krimeve të realizuara nga fëmijë gjatë intervalit kohorë nga viti 2017 deri më vitin 2019 në RMV

Viti	2017	2018	2019
	Gjithsej	Gjithsej	Gjithsej
Gjithsej	368	330	304

Burimi: www.stat.gov.mk

Tabela nr. 3 Numri i përgjithshëm i fëmijëve të gjykuar sipas gjinisë gjatë intervalit kohorë nga viti 2017 deri më vitin 2019 në RMV

Viti	2017			2018			2019		
	Gjithsej	Meshkuj	Femra	Gjithsej	Meshkuj	Femra	Gjithsej	Meshkuj	Femra
Gjithsej	368	354	14	330	313	17	304	287	17

Burimi: www.stat.gov.mk

Nga të dhënat statistikore rezulton se numri më i madh i fëmijëve të cilët janë gjykuar për vepra penale të kryera në RMV të jetë nga gjinia mashkullore edhe atë me një numër të lartë diferencial. Në vitin 2017, nga gjithsej 368-të fëmijë të gjykuar për kryerjen e veprave penale, 354 janë meshkuj ndërsa vetëm 14-të fëmijë janë të gjinisë femrore. E njejta diferencë e lartë qëndron edhe gjatë viteve në vijim të paraqitura në tabelën më lartë.

Tabela nr. 4 Numri i fëmijëve të gjykuar nga mosha 14-16 gjatë intervalit kohorë nga viti 2017 deri më vitin 2019 në RMV

Viti	2017	2018	2019
	Gjithsej	Gjithsej	Gjithsej
Gjithsej	112	73	82

Burimi: www.stat.gov.mk

Nga të dhënat statistikore rezulton se numri i fëmijëve të rinjë, të moshës 14-16 të gjykuar, numri më i lartë është gjatë vitit 2017, pastaj vitin 2019, duke pasur një ulje të vogël gjatë vitit 2018.

Tabela nr. 5 Numri i fëmijëve të gjykuar nga mosha 16-18 gjatë intervalit kohorë nga viti 2017 deri më vitin 2019 në RMV

Viti	2017	2018	2019
	Gjithsej	Gjithsej	Gjithsej
Gjithsej	256	257	218

Burimi: www.stat.gov.mk

Nga të dhënat statistikore rezulton se numri i fëmijëve të gjykuar të moshës 16-18, është më gati se identik gjatë viteve 2017 dhe 2018, duke pësuar rënie gjatë vitit 2019. Vlen të theksohet se numri i fëmijëve të rinj dhe fëmijëve të moshës më të madhe të cilët janë të gjykuar për vepra penale është për dyfish më i lartë sesa i fëmijëve të rinj.

Tabela nr. 6 Numri i fëmijëve që u janë shqyrtuar masa sanksionimi në bazë të veprave penale të kryera gjatë intervalit kohor nga viti 2017 deri më vitin 2019 në RMV

	Sanksione të miratuara	Ndalesat të veprimave	Vepra nuk ka shenja të veprës penale dhe vepra të rëndësishme të vogël	Nuk egzistojnë dëshmi që i pandehuri e ka kryer veprën penale	Arsye integriteti	Rrethena që përjashtojnë përndjekjen	Akuzuesi e ka tërhequr akuzën	Masa sigurie
Vepra penale kundër jetës dhe trupit	38	21	2	1	1	16	1	-
Vepra penale kundër lirisë dhe të drejtave të njeriut dhe qytetarit	3	2	-	-	1	1	-	-
Vepra penale kundër lirisë dhe moralit gjinor	2	7	-	1	4	-	1	1
Vepra penale kundër shëndetit të njerëzve	18	4	1	-	2	1	-	-
Vepra penale kundër martesës dhe familjes dhe rinisë	1	1	1	-	-	-	-	-
Vepra penale kundër mjedisit jetësor dhe natyrës	-	3	-	-	2	1	-	-

Vepra penale kundër pasurisë	181	119	26	9	25	47	12	-
Vepra penale kundër financave publike, qarkullimit pagesor dhe ekonomisë	1	-	-	-	-	-	-	-
Vepra penale kundër sigurisë së përgjithshme të njerëzve dhe pronës	3	-	-	-	-	-	-	-
Vepra penale kundër sigurisë së trafikut publik	24	5	-	-	-	3	2	-
Vepra penale kundër drejtësisë	-	-	-	-	-	-	-	-
Vepra penale kundër rendit gjyqës	1	-	-	-	-	-	-	-
Vepra penale kundër rendit publik	29	4	-	-	1	1	2	-

Vepra penale të tjera	3	-	-	-	-	-	-	-
------------------------------	----------	---	---	---	---	---	---	---

Burimi: www.stat.gov.mk

Nga të dhënat statistikore për sanksione të miratuara tek fëmijët në bazë të veprave penale të kryera rezulton si vijon: për vepër penale kundër jetës dhe trupit nga gjithsej 38 sanksione numri më i madh prej tyre janë ndalesa të veprimeve. Për vepra penale kundër lirive dhe të drejtave të njeriut janë shqiptuar 3 sanksione prej të cilave dy janë ndalesa veprimi. Për vepra penale kundër lirisë dhe moralit gjinor numri më i madh i sanksioneve është vlersuar si mbrojtje integriteti. Për vepra penale kundër shëndetit të njerëzve numri më i madh i sanksioneve është vepruar me ndalesa veprimi. Numri më i madh i veprave penale të kryera të pasuara me sanksione është vërejtur tek veprat penale kundër pasurisë për të cilat, nga numri total i paraqitur i sanksioneve 181, 119 prej tyre kanë pësuar me ndalesa veprimi.

Tabela nr. 7 Fëmijë të gjykuar sipas rrethit familjar dhe grupeve të veprave penale të kryera gjatë intervalit kohorë nga viti 2017 deri më vitin 2019 në RMV

Viti	2017	2018	2019
Gjithsej	368	330	302

Burimi: www.stat.gov.mk

4.2 Të dhëna statistikore për fëmijë të përfshirë në sistemin e drejtësisë për Republikën e Kroacisë

Tabela nr. 8 Numri i fëmijëve të përfshirë në vepra penale sipas veprës penale në Kroaci në vitin 2015

Vepra penale	Të Paraqitur	Të akuzuar	Të gjykuar
Totali	1739	492	420
Vepra penale kundër jetës dhe trupit	210	50	44
Vepra penale kundër lirive dhe të drejtave të njeriut dhe qytetarit	94	7	6
Vepra penale kundër lirisë dhe moralit gjinor	11	5	4

Vepra penale	Të Paraqitur	Të akuzuar	Të gjykuar
Vepra penale kundër martesës dhe familjes dhe rinisë	18	18	16
Vepra penale kundër shëndetit të njerëzve	79	44	41
Vepra penale kundër pronës	1177	330	280
Vepra penale për falsifikim	25	5	4
Vepra penale kundër rendit publik	29	15	10
Vepra penale të tjera	96	18	15

Burimi: www.dzs.hr

Nga tabela më lartë rezulton se numri i përgjithshëm i fëmijëve të paraqitur për kryerje të veprave penale në vitin 2015 është 1739, nga te cilët vetëm 492 janë të akuzuar për veprat e kryera ndërsa 420 prej tyre janë të gjykuar për kryerjen e veprës penale. Për nga lloji i veprës penale të kryer rezulton se numri më i lartë i rasteve të paraqitura është për krime kundër pronës duke përfshirë numrin 1177 nga 1739 totali i rasteve të paraqitura. Numri më i ulët i veprave penale të paraqitura janë në lidhje me krimet kundër lirisë dhe moralit gjinor me 11 raste të paraqitura.

Tabela 8.1 Kohzgjatja e dënimit sipas veprës penale të kryer dhe numri i fëmijëve të dënuar në Kroaci në vitin 2015

Kohzgjatja e dënimit sipas veprës penale të kryer	Numri i të fëmijëve të dënuar
Deri më 1 muaj	403
1-2 muaj	282
2-4 muaj	421
4-6 muaj	319
6-12 muaj	262
Më shumë se 1 vit	52

Burimi: www.dsz.hr

Kohzgjatja më e frekuentuar e dënimit sipas veprave penale të kryera rezulton periudha nga 2 deri në 4 muaj duke u bazuar në veprat penale të kryera nga tabela paraprake.

Tabela 8.2 Masat e sanksionimit të fëmijëve madhorë dhe të fëmijëve të rinjë

Masat e sanksionimit të të fëmijëve	Fëmijë madhorë	Fëmijë të rinjë
Burg i fëmijëve	9	-
Burg i pezulluar për fëmijë	45	-
Masat edukuese	236	130
Dërgimi në qendër dicipline	15	7
Kujdes dhe mbikqyrje e shtuar	90	38
Kujdes dhe mbikqyrje e shtuar, si dhe qëndrim në qendër korrektuese	3	2
Dërgimi në qendër rehabilituese	11	10
Dërgimi në institucion korrigjues special	1	5

Burimi: www.dsz.hr

Nga tabela më lartë rezulton se nga sanksionet e theksuara për fëmijë madhorë dhe fëmijë të rinjë nuk egziston ndonjë larmishmëri në llojet e sanksioneve në bazë të veprave penale të kryera. Numri më i lartë i sanksioneve tek fëmijët madhorë rezulton të jetë masa edukuese me 236 të sanksionuar, dhe numri më i ulët në dërgimin në institucion special korrigjues me 1 fëmijë madhor të sanksionuar. Numri më i lartë i sanksioneve tek fëmijët e rinjë gjithashtu është me masa edukuese me 130 të sanksionuar, dhe numri më i ulët është me sanksionim me kujdes dhe mbikqyrje të shtuar, si dhe qëndrim në qendër korrektuese me 2 të sanksionuar.

Tabela nr. 9 Numri i fëmijëve të përfshirë në vëpra penale sipas veprës penale të kryer në Kroaci për vitin 2016

Vepra penale	Të Paraqitur	Të akuzuar	Të gjykuar
Totali	1532	422	365
Vepra penale kundër jetës dhe trupit	177	39	34
Vepra penale kundër lirive dhe të drejtave të njeriut dhe qytetarit	90	14	7

Vepra penale	Të Paraqitur	Të akuzuar	Të gjykuar
Vepra penale kundër lirisë dhe moralit gjinor	13	4	4
Vepra penale kundër martesës dhe familjes dhe rinisë	31	14	13
Vepra penale kundër shëndetit të njerëzve	71	41	35
Vepra penale kundër pronës	1017	278	248
Vepra penale për falsifikim	11	3	3
Vepra penale kundër rendit public	31	15	9
Vepra penale të tjera	91	14	12

Burimi: www.dsz.hr

Në Kroaci gjatë vitit 2016 janë paraqitur 1532 vepra penale dhe nga tabela më lartë rezultojnë nga ato vetëm 422 fëmijë kryes të veprave penale janë akuzuar dhe 365 prej tyre janë gjykuar. Numri më i lartë i veprave penale të kryera rezultojnë të jetë në vepra penale kundër pronës me 1017 raste të paraqitura, 278 prej të cilave kanë pasuar me akuzime të fëmijëve, dhe 248 fëmijë të gjykuar për vepra penale. Numri më i ulët i veprave penale të kryera nga fëmijë janë vepra penale për falsifikim me 11 të paraqitur, prej të cilëve 3 janë të akuzuar dhe 3 të gjykuar.

Tabela 9.1 Kohëzgjatja e dënimit sipas veprës penale të kryer dhe numri i fëmijëve të dënuar në Kroaci në vitin 2016

Kohëzgjatja e dënimit sipas veprës penale të kryer	Numri i fëmijëve të dënuar
Deri më 1 muaj	361
1-2 muaj	215
2-4 muaj	341
4-6 muaj	284
6-12 muaj	287
Më shumë se 1 vit	44

Burimi: www.dsz.hr

Kohëzgjatja më e frekuentuar e dënimit sipas veprave penale të kryera rezultojnë periudha me dënim deri më 1 muaj duke u bazuar në veprat penale të kryera nga tabela paraprake.

Tabela 9.2 Masat e sanksionimit të fëmijëve madhorë dhe të fëmijëve të rinjë

Masat e sanksionimit të të fëmijëve	Fëmijë të madhorë	Fëmijë të rinjë
Burg i të fëmijëve	8	-
Burg i pezulluar për të fëmijë	34	-
Masat edukuese	200	123
Dërgimi në qendër dicipline	21	11
Kujdes dhe mbikqyrje e shtuar	65	44
Kujdes dhe mbikqyrje e shtuar, si dhe qëndrim në qendër korrektuese	-	1
Dërgimi në qendër rehabilituese	12	14
Dërgimi në institucion korigjues special	2	6

Burimi: www.dsz.hr

Nga tabela më lartë rezulton se numri më i lartë i sanksioneve tek fëmijët madhorë rezulton të jetë masa edukuese me 200 të sanksionuar, dhe numri më i ulët në dërgimin në institucion special korigjues me 2 fëmijë madhor të sanksionuar. Numri më i lartë i sanksioneve tek fëmijët e rinjë gjithashtu është me masa edukuese me 123 të sanksionuar, dhe numri më i ulët është me sanksionim me kujdes dhe mbikqyrje të shtuar, si dhe qëndrim në qendër korrektuese me 1 i sanksionuar.

Tabela nr. 10 Numri i fëmijëve të përfshirë në vepra penale sipas veprës penale të kryer në Kroaci për vitin 2017

Vepra penale	Të Paraqitur	Të akuzuar	Të gjykuar
Totali	1575	380	333
Vepra penale kundër jetës dhe trupit	142	33	26
Vepra penale kundër lirisë dhe të drejtave të njeriut dhe qytetarit	87	25	19
Vepra penale kundër lirisë dhe moralit gjinor	11	7	6

Vepra penale	Të Paraqitur	Të akuzuar	Të gjykuar
Vepra penale kundër martesës dhe familjes dhe rinisë	58	24	21
Vepra penale kundër shëndetit të njerëzve	77	44	42
Vepra penale kundër pronës	997	216	191
Vepra penale për falsifikim	31	3	3
Vepra penale kundër rendit publik	67	16	15
Vepra penale të tjera	105	12	10

Burimi: www.dsz.hr

Gjatë vitit 2017 janë paraqitur 1575 vepra penale dhe nga tabela më lartë rezulton se nga ato vetëm 380 fëmijë kryes të veprave penale janë akuzuar dhe 333 prej tyre janë gjykuar. Numri më i lartë i veprave penale të kryera rezulton të jetë në vepra penale kundër pronës me 997 raste të paraqitura, 216 prej të cilave kanë pasuar me akuzime të fëmijëve, dhe 191 fëmijë të gjykuar për vepra penale. Numri më i ulët i veprave penale të kryera nga fëmijë janë vepra penale kundër lirisë dhe moralit gjinor me 11 të paraqitur, prej të cilëve 7 janë të akuzuar dhe 6 të gjykuar.

Tabela 10.1 Kohëzgjatja e dënimit sipas veprës penale të kryer dhe numri i fëmijëve të dënuar në Kroaci në vitin 2017

Kohëzgjatja e dënimit sipas veprës penale të kryer	Numri i të fëmijëve të dënuar
Deri më 1 muaj	317
1-2 muaj	241
2-4 muaj	398
4-6 muaj	328
6-12 muaj	252
Më shumë se 1 vit	39

Burimi: www.dsz.hr

Kohëzgjatja më e frekuentuar e dënimit sipas veprave penale të kryera rezulton periudha me dënim prej 2 deri 4 muaj duke u bazuar në veprat penale të kryera nga tabela paraprake.

Tabela 10.2 Masat e sanksionimit të fëmijëve madhorë dhe fëmijëve të rinjë

Masat e sanksionimit të të fëmijëve	Fëmijë madhorë	Fëmijë të rinjë
Burg i të fëmijëve	11	-
Burg i pezulluar për të fëmijë	36	-
Masat edukuese	179	107
Dërgimi në qendër dicipline	16	11
Kujdes dhe mbikqyrje e shtuar	69	33
Kujdes dhe mbikqyrje e shtuar, si dhe qëndrim në qendër korrektuese	4	4
Dërgimi në qendër rehabilituese	13	8
Dërgimi në institucion korigjues special	-	4

Burimi: www.dsz.hr

Nga tabela më lartë rezulton se numri më i lartë i sanksioneve tek fëmijët madhorë rezulton të jetë masa edukuese me 179 të sanksionuar, dhe numri më i ulët në dërgimin në institucion special korigjues me 4 fëmijë madhor të sanksionuar. Numri më i lartë i sanksioneve tek fëmijët e rinjë gjithashtu është me masa edukuese me 107 të sanksionuar, dhe numri më i ulët është me sanksionim me kujdes dhe mbikqyrje të shtuar, si dhe qëndrim në qendër korrektuese me 4 të sanksionuar.

Tabela nr. 11 Numri i fëmijëve të përfshirë në vëpra penale sipas veprës penale të kryer në Kroaci për vitin 2018

Vepra penale	Të Paraqitur	Të akuzuar	Të gjykuar
Totali	1196	347	302
Vepra penale kundër jetës dhe trupit	142	28	26
Vepra penale kundër lirisë dhe të drejtave të njeriut dhe qytetarit	78	16	15
Vepra penale kundër lirisë dhe moralit gjinor	6	4	4

Vepra penale	Të Paraqitur	Të akuzuar	Të gjykuar
Vepra penale kundër martesës dhe familjes dhe rinisë	46	25	24
Vepra penale kundër shëndetit të njerëzve	52	35	30
Vepra penale kundër pronës	690	193	167
Vepra penale për falsifikim	24	10	6
Vepra penale kundër rendit publik	59	15	9
Vepra penale të tjera	99	21	21

Burimi: www.dsz.hr

Gjatë vitit 2016 në Kroaci janë paraqitur 1196 vepra penale dhe nga tabela më lartë rezultojnë se nga ato vetëm 347 fëmijë kryes të veprave penale janë akuzuar dhe 302 prej tyre janë gjykuar. Numri më i lartë i veprave penale të kryera rezultojnë të jetë në vepra penale kundër pronës me 690 raste të paraqitura, 193 prej të cilave kanë pasuar me akuzime të fëmijëve, dhe 167 fëmijë të gjykuar për vepra penale. Numri më i ulët i veprave penale të kryera nga fëmijë janë vepra penale kundër lirisë dhe moralit gjinor me 6 të paraqitura, prej të cilëve 4 janë të akuzuar dhe 4 të gjykuar.

Tabela 11.1 Kohëzgjatja e dënimit sipas veprës penale të kryer dhe numri i fëmijëve të dënuar në Kroaci në vitin 2018

Kohëzgjatja e dënimit sipas veprës penale të kryer	Numri i të fëmijëve të dënuar
Deri më 1 muaj	197
1-2 muaj	172
2-4 muaj	246
4-6 muaj	263
6-12 muaj	224
Më shumë se 1 vit	94

Burimi: www.dsz.hr

Kohëzgjatja më e frekuentuar e dënimit sipas veprave penale të kryera rezulton periudha me dënim prej 4 deri 6 muaj duke u bazuar në veprat penale të kryera nga tabela paraprake.

Tabela 11.2 Masat e sanksionimit të fëmijëve madhorë dhe të fëmijëve të rinjë

Masat e sanksionimit të të fëmijëve	Fëmijë madhorë	Fëmijë të rinjë
Burg i të fëmijëve	11	-
Burg i pezulluar për të fëmijë	36	-
Masat edukuese	179	107
Dërgimi në qendër dicipline	16	11
Kujdes dhe mbikqyrje e shtuar	69	33
Kujdes dhe mbikqyrje e shtuar, si dhe qëndrim në qendër korrektuese	4	4
Dërgimi në qendër rehabilituese	13	8
Dërgimi në institucion korigjues special	-	4

Burimi: www.dsz.hr

Nga tabela më lartë mund të vërejmë se numri më i lartë i sanksioneve tek fëmijët madhorë rezulton të jetë masa edukuese me 179 të sanksionuar, dhe numri më i ulët në dërgimin në institucion special korigjues me 4 fëmijë madhor të sanksionuar. Numri më i lartë i sanksioneve tek fëmijë e rinjë gjithashtu është me masa edukuese me 107 të sanksionuar, dhe numri më i ulët është me sanksionim me kujdes dhe mbikqyrje të shtuar, si dhe qëndrim në qendër korrektuese me 4 të sanksionuar dhe 4 të sanksionuar me dërgim në institucion korigjues special.

4.3 Të dhëna statistikore për fëmijë të përfshirë në sistemin e drejtësisë për Republikën e Shqipërisë

Tabela nr. 12 Vepra penale dhe procedura penale te paraqitura gjatë intervalit kohorë nga viti 2015 deri më vitin 2018 në Republikën e Shqipërisë

Viti	2015	2016	2017	2018

Vrasje me dashje	54	71	50	51
Vrasje të mbetura në tentativë	138	132	129	114
Krime kundër shëndetit	2892	2579	2650	2493
Krime seksuale	149	120	113	110
Vjedhje (Neni134)	5091	4363	4351	4532
Vjedhje me dhunë	182	138	169	108
Vjedhje me armë	49	15	13	22
Vjedhje duke keqpërdorur detyrën	150	81	118	70
Mashtrime	803	1031	1127	1040
Falsifikime monetare	125	73	85	82
Dhuna në familje	1300	1488	2070	1374
Krime në fushën e drogës	2321	3248	5316	1907
Shkelje të rregullave të qarkullimit rrugor	5280	5257	16.714	5713
Të tjera	17330	15112	-	16852

Burimi: www.instat.gov.al

Në tabelën e mësipërme janë paraqitur numri i përgjithshëm i veprave penale të paraqitura të cilat janë të kryera gjatë periudhës kohore që nga viti 2015 deri në vitin 2018. Nga të dhënat e Entit Statistikor të Republikës së Shqipërisë të paraqitura në tabelë rezulton se numri më i lartë i veprave penale të kryera gjatë vitit 2015 janë paraqitur në shkelje të rregullave të qarkullimit rrugor me 5280 raste, pastaj krime me vjedhje 5091, krime kundër shëndetit 2892, krime në fushën e drogës 2321 si dhe dhuna në familje me 1300 raste të paraqitura. Gjatë vitit 2016 pason njëjtë me numër më të lartë të veprave penale të kryera në krime shkelje të rregullave të qarkullimit rrugor 5257, vjedhje 4363, krime në fushën e drogës 3248, dhe dhunë në familje 1488.

Gajtë vitit 2017 kemi numër të madh të shkeljeve të rregullave të qarkullimit rrugor 16719, krime droge 5316, vjedhje 4351, krime kundër shëndetit 2650 si dhe dhunë në familje 2070. Gjatë vitit 2018 janë paraqitur vepra penale të llojit krime shkelje të rregullave të qarkullimit rrugor 5713, vjedhje 4532, krime në fushën e drogës 1907, dhe dhunë në familje 1374, si dhe krime kundër shëndetit me 2493 raste të paraqitura.

Tabela nr. 13 Numri i të fëmijëve autorë kryerës të veprës penale gjatë intervalit kohorë 2017 - 2019

Viti	2017	2018	2019
Gjithsej	2053	1591	1337

Burimi: www.instat.gov.al

Sipas tabelës së paraqitur rezulton se numri më i madh i veprave penale të kryera nga fëmijët të ketë qenë gjatë vitit 2017, me 2052 raste të paraqitura.

Tabela nr. 14 Fëmijë të pandehur për vepra penale nga mosha 14- 17 gjatë intervalit kohorë 2015 - 2019

Viti	Të Paraqitur	Të dënuar	Të burgosur
2015	995	601	87
2016	790	562	58
2017	570	283	39
2018	555	296	21
2019	448	280	23

Burimi: www.instat.gov.al

Në tabelën e mësipërme janë paraqitur numri i të pandehurve fëmijë të cilët janë kryerës të veprave penale, dhe sipas të njejtës rezulton se numri më i madh i paraqitur i fëmijëve ka qenë gjatë vitit 2015, me një numër prej 995 të paraqitur, 601 prej tyre janë dënuar në bazë të veprës penale të kryer dhe 87 prej tyre janë burgosur. Numri më i vogël i fëmijëve të paraqitur për vepra penale të kryera rezulton të jetë gjatë vitit 2019 me 448 fëmijë të paraqitur për vepra penale, 280 prej të cilëve janë dënuar dhe vetëm 23 fëmijë janë burgosur për veprat penale të kryera.

Tabela nr. 15 Numri i fëmijëve të akuzuar sipas gjinisë gjatë intervalit kohorë 2015 - 2017

Viti	Meshkuj	Femra
2015	390	30
2016	331	34
2017	294	39

Burimi: www.instat.gov.al

Sipas tabelës së paraqitur më lartë mund të vërejmë se numri më i lartë i të akuzuarve fëmijë gjatë viteve 2015-2017 të ndarë në gjini, rezulton të jenë meshkuj me një dallim drastik të numrit të të akuzuarve në krahasim me femrat.

Tabela nr.16 Loji i veprave penale të kryera nga fëmijë ndarë në gjini gjatë intervalit kohorë 2015-2017

Viti		2015	2016	2017
Sulm	Femra	15	18	9
	Meshkuj	136	97	78
Sulme serioze	Femra	16	9	5
	Meshkuj	337	405	312
Dhunim	Femra	0	0	0
	Meshkuj	115	117	105
Vjedhje	Femra	29	18	16
	Meshkuj	292	270	237
Krime vjedhjelesh	Femra	219	360	363
	Meshkuj	1376	1607	1359
Vrasje	Femra	7	8	9
	Meshkuj	68	58	51
Krime droge	Femra	39	58	49
	Meshkuj	643	680	649

Të tjera	Femra Meshkuj	1156 8524	1251 8821	1143 8029
-----------------	--------------------------	--------------	--------------	--------------

Burimi: www.instat.gov.al

Nga tabela e mësipërme mund të vërehet një dallim drastik kur është në pyetje kryerja e veprave penale tek fëmijët e gjinisë femërore me ato të gjinisë mashkullore duke rezultuar të jetë gjinia mashkullore shumë më e prirur për të kryer vepra penale si sulme të ndryshme, dhunime, vrasje, krime vjedhjesh dhe të tjera. Mirëpo nëse e bëjmë ndarjen e veprave të cilat janë kryer më së shumti nga ana e fëmijëve meshkuj rezulton të jetë si vijon, sulme meshkujt fëmijë kanë kryer më së shumti gjatë vitit 2015, sulme serioze më së shumti kanë kryer gjatë vitit 2016, numri i dhunimeve gjason të jetë shumë i ngjajshëm gjatë tërë intervalit kohorë, vjedhje kemi të kryera më së shumti në vitin 2015, krime vjedhjesh më së shumti në vitin 2016, vrasje gjatë vitit 2015, krimet e drogës të kryera nga meshkujt fëmijë qëndrojnë thuajse identike në numra gjatë gjithë viteve në fjalë. Numri i krimeve të llojeve tjera qëllon të jetë i lartë si nga fëmijët femra ashtu edhe meshkuj, mirëpo numri më i madh i krimeve janë kryer definitivisht nga meshkujt fëmijë në Republikën e Shqipërisë edhe atë gjatë vitit 2016.

Përfundime dhe rekomandime

Ky studim mbi fëmijët në konflikt me ligjin, synoi që përveç evidentimit të faktorëve psiko-socialë të riskut dhe përshkrimit të profileve të fëmijëve, të formulojë dhe disa konkluzione të përgjithshme mbi rezultatet e studimit të cilat do të ishin me interes për të gjithë subjektet e interesuara për këtë kategori dhe veçanërisht për hartimin e politikave të parandalimit të kriminalitetit dhe rehabilitimit të fëmijëve që janë përfshirë në kryerjen e veprave penale. Bazuar në rezultatet e këtij studimi mund të thuhet se kriminaliteti i fëmijëve në Republikën e Maqedonisë Veriore ka qenë dhe mbetet një problem shqetësues për shoqërinë tonë. Fakti që pothuajse të gjithë fëmijët të përfshirë në vepra penale për periudhën e studiuar rezulton të jenë meshkuj, tregon se meshkujt ka më shumë gjasa të përfshihen në kryerjen e veprave penale. Fakti që pjesa më e madhe e fëmijëve janë akuzuar apo dënuar për kryerjen e veprës penale të vjedhjes në forma të ndryshme, është në përputhje me faktorë të tjerë si gjendja e vështirë

ekonomike, mungesa e arsimit apo formimit profesional. Të gjithë këta faktorë bëjnë që fëmijë të mos kenë zgjedhje dhe të mundohen për të siguruar burime mbijetese në mënyrë të jashtëligjshme.

Një element shumë pozitiv është hartimi dhe zbatimi i programeve rehabilituese të fëmijëve në institucionet penitenciare. Megjithatë, këto programe nuk mund të sjellin ndryshime të qëndrueshme në përmirësimin e sjelljes së fëmijëve, nëse nuk reduktohen faktorët e riskut si dhe nëse nuk ekzistojnë struktura që ofrojnë programe ri-integruese për periudhën pas lirit.

Parandalimi dhe ndërhyrja si masa rekomanduese

Parandalimi dhe ndërhyrja janë dy koncepte të ndryshme. Parandalimi nënkupton marrjen e masave për të mos lejuar shfaqjen e problemit dhe drejtohet ndaj të gjithë popullatës. Ndërhyrja realizohet me individët më të rrezikuar, apo të përfshirë në sjellje kriminale dhe synon reduktimin apo eliminimin e sjelljeve problematike.

Modelet e suksesshme të parandalimit të kriminalitetit të fëmijëve

Ekzistojnë programe të ndryshme, të cilat kanë rezultuar të suksesshme për parandalimin dhe trajtimin e sjelljeve delikvente. Në përgjithësi programe efikase konsiderohen ato që: Identifikojnë faktorët e riskut dhe ata mbrojtës, ndaj të cilëve janë të ekspozuar fëmijë, fokusohen më shumë tek fëmijët e ekspozuar ndaj faktorëve të rrezikut, ofrojnë ndërhyrje në plane/drejtime të ndryshme, janë intensive dhe të vazhdueshme, marrin në konsideratë pikat e forta dhe të dobëta të fëmijëve, merren jo vetëm me individin, por dhe me ambientin social që e rrethon. Parandalimi i hershëm redukton gjasat që fëmijët të përfshihen në sjellje problematike. Për fëmijët të cilët janë përfshirë në sjellje kriminale ndërtohen programe specifike trajtimi.

Qëllimi i trajtimit nëpërmjet këtyre programeve është të mësohet e strategjive për të rritur nivelin e ndërgjegjësisimit dhe të autokontrollit në përballje me situata problematike. Në aplikimin e programeve është e rëndësishme të punuarit në ekipe multi-disiplinare, për trajtimin në aspekte të ndryshme (psiko-sociale, edukative, arsimore).

Menaxhimi i fëmijëve me tendenca për tu përfshirë në sjellje delikvente është një sfidë e vazhdueshme. Zhvillimi i marrëdhënieve ndërpersonale mund të jetë një nga qëllimet e trajtimit. Vendosja e një marrëdhënieje besimi me individin do të jetë më produktive sesa konfrontimi me zemërim, ndëshkimet dhe disiplina e rreptë. Vendosja e kufijve dhe e pritshmërive të qëndrueshme dhe me sens logjik është me rëndësi në mënyrë që të kultivohet përgjegjshmëria individuale për veprimet e kryera. Për një trajtim sa më efektiv rekomandohet bashkëpunimi me familjen, përfshirja në programe arsimimi si dhe caktimi i detyrave specifike të cilat kanë një qëllim të caktuar.

KONKLuzion

Lufta ndaj kriminalitetit dhe mbrojtja e interesit më të lartë të fëmijës është në fokus të ligjvënësit sepse përfshirja e fëmijëve në strukturat kriminale vetëm vjen duke u rritur. Në kuadër të luftës kundër kriminalitetit të fëmijëve janë bërë ndryshime të shumta legislative por vazhdon të jetë ende një sfidë realizimi i ndryshimeve institucionale të cilat do të çonin në zbatimin me efikasitet të normave ligjore. Në këtë pjesë të drejtësisë penale lidhen shumë struktura dhe shumë çështje që kanë të bëjë me legjislacionin mbi fëmijët.

Të tilla janë strukturat përgjegjëse për zbatimin e tij, strukturat e ndihmës mbështetëse të administratës publike, strukturat përgjegjëse për integrimin social të tyre, rehabilitimin e fëmijëve në konflikt me ligjin, strukturat përgjegjëse për mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve viktimë dhe strukturat përgjegjëse për parandalimin e kryerjes së veprës penale dhe sigurimi i rendit publik gjatë administrimit të drejtësisë. Të drejtat e fëmijëve dhe konfliktet e tyre me ligjin nuk janë fenomene të sotshme. Ato kanë ekzistuar që në fazat embrionale të hartimit të legjislacioneve dhe në varësi të periudhave dhe të nevojave të momentin ato kanë pësuar ndryshime pozitive.

Kriminaliteti i fëmijëve i ka rrënjët që me krijimin e shoqërisë njerëzore. Në periudhën ku ende nuk mund të flitej për ligje dhe norma ligjore, fillimisht përgjegjësia e fëmijëve ka qenë objektive më vonë me hartimin e normave të para ligjore që më vonë është shëndërruar në përgjegjësi penale. Për fëmijë kanë pasur një pozitë juridiko - penale më të lehtë dhe më të favorshme në krahasim me të rriturit për faktin se fëmijët nuk kanë arritur pjekurinë e duhur biopsikike.

Në shekullin e XX filloi një ndikimin i shkollës sociologjike në hartimin e legjislacioneve penale. Në këtë periudhë u rrit rëndësia e përcaktimit të moshës për përgjegjësi penale të fëmijëve ku konsideroheshin maxhorenë personat që kishin mbushur moshën 18 vjeç dhe konsiderohen si penalisht të papërgjegjshëm fëmijët të cilat nuk kanë mbushur moshën 14 vjeçare në momentin e realizimit të një veprë penale. Në vitet tridhjetë të shekullit XX në shumicën e legjislacioneve penale u përqaftuan masat edukuese, si lloje të posaçme të sanksioneve penale. Një nga parimet më të rëndësishme në përcaktimin e kufirit të moshës së fëmijërisë e për rrjedhojë të moshës për përgjegjësi penale është parimi i interesit më të lartë të fëmijës. Sipas Kushtetutës tonë, edhe pse nuk ka një nen të veçantë lidhur me interesin më të lartë të fëmijës, ajo i ofron mbrojtje të veçantë që ka për qëllim të tregojë dhe një status të një kujdesi më të madh për fëmijët, i cili duhet të reflektohet jo vetëm në legjislacion por edhe në të gjithë veprimtarinë e organeve shtetërore dhe subjekteve në kontakt me fëmijët. Përcaktimi i moshës për përgjegjësi penale lidhet ngushtë me detyrimin e shteteve në krijimin e një sistemi efektiv të drejtësisë penale për fëmijë. Moshë për përgjegjësi penale është konsideruar moshë për të cilën një person mund të konsiderohet përgjegjës për një vepër penale dhe mund t'i nënshtrohet procedurave penale. Moshë për përgjegjësi penale ndryshon nga një vend në tjetrin në bazë të zhvillimit shoqëror dhe kulturore të një vendi. Në legjislacionin tonë e gjejmë të sanksionuar moshën për përgjegjësi penale ku përcaktohet se “Ka përgjegjësi penale personi që në kohën e kryerjes së një krimi ka mbushur moshën katërbëdhjetë vjeç”. Pra është sanksionuar moshë për përgjegjësi penale për veprat penale dhe kundërvajtjet ligjore, duke përcaktuar si moshën minimale edhe atë katërbëdhjetë vjeçare.

Me ndryshimet e shumta kulturore, sociale dhe ekonomike përfshirja e të rinjve në veprimtari kriminale ka ardhur gjithnjë e në rritje. Duke analizuar dhe kuptuar shkaqet e këtij fenomeni mund të përcaktohet trajtimi i duhur për këtë kategori personash. Në rritjen e kriminalitetit ndikojnë faktorët e brendshëm dhe të jashtëm. Në faktorët e brendshëm përfshihen personaliteti i fëmijëve dhe karakteri i fëmijëve.

Aspekti procedural i trajtimit të një akti kriminal ku është përfshirë një fëmijë ka një rëndësi esenciale që fillon në momentin e parë të ndalimit dhe vazhdon me të njëjtin intensitet deri në procesin gjyqësor. Kjo për faktin se një procedurë e papërshtatshme do të cënonte të drejtat dhe

liritë themelore të fëmijëve në veçanti dhe të çdo individi tjetër në përgjithësi. Në Kodin e Procedurës Penale janë parashikuar rregulla për mënyrën e ndjekjes, hetimit dhe gjykimit të veprave penale.

Fëmijët janë një kategori personash të favorizuar për shkak të pozitës së tyre por edhe ndaj tyre kur vërtetohet se ata janë autorë të veprave penale shteti aplikon sanksione penale. Në aplikimin e sanksioneve duhet të merret në konsideratë nevoja për edukimin dhe mirëqenien e fëmijëve. Masat të cilat do të gjejnë trajtim janë dënimi me burgim, masat edukuese dhe alternativat e dënimit me burgim. Si alternativa të dënimit janë gjysëmliria, pezullimi i ekzekutimit të vendimit me burgim dhe vënia në provë, qëndrimi në shtëpi, pezullimi i ekzekutimit të dënimit me burgim dhe detyrimi për kryerjen e një pune në interes publik dhe lirimi me kusht.

BIBLIOGRAFIA

1. Ahmedi, A. B., "Delikuenca e fëmijëve" UEJL, 2019 (Dispense)
2. Ahmedi, A. B., Trajtimi Juridiko-Penal i Fëmijëve në Republikën e Maqedonisë së Veriut, Tetovë 2021
3. Boica, C., "Criminal Responsibility of Minors in the Republic of Croatia" Vol. 1 pages 263-275., 2004
4. Collaku, H. Efikasiteti i Procedurës Penale për fëmijë dhe ruajtja e identitetit të fëmijë, UDC 343.137.5
5. Dunkel, F., Criminology and Criminal Justice and Juvenile Delinquency, International and Comparative Criminology., 2016
6. Delorme., A. "Statistical Methods", Schwarz Center for Computational Neuroscience, INC., University of San Diego.
7. Gjolena., A. "Pozita penalo-juridike e të miturve si subjekt aktiv në kriminalitet" Universiteti European i Tiranës, Tiranë, 2017
8. Hoecke., V. M. "Methodology of Comparative Legal Research Law and Method.
9. Halili, R. Penologjia, "E drejta e Ekzekutimit të sanksioneve Penale", Prishtinë 2014
10. "Introduction to Data analysis Handbook", Academy for Educational Development, 2006
11. Jakupi, A., "Metodologjia e punës Shkencore Kërkimore" Prishtinë, 2005
12. Kushtetuta e Republikës së Maqedonisë, Nëntor 1991
13. Kambovski, V., E Drejta Penale 'Pjesa e Pergjithshme', 2010, Shkup
14. Kosumi, M., dhe Shasivari, R., "Procedura Penale ndaj fëmijëve"
15. Kodi i Drejtisë Penale Për fëmijë i Republikës së Shqipërisë n. 37/ 2017
16. Loeb., S. Dynarski., S. McFarland., D. Morris., P. Reardon., S. Reber., S. Descriptive analysis in Education: A guide for researchers. 2017
17. Lyman Ott., R "An Introduction to Statistical Methods and Data analysis, Fifth edition, 2001
18. Ligji për procedurë Penale i Republikës së Maqedonisë
19. Mathews, S. Schiraldi, V., `chester., L. "Youth Justice in Europe: Experience of Germany, the Netherlands, and Croatia in providing Developmentally appropriate responses to emerging adults in the Criminal Justice system, Justice Evaluation Journal, Routledge.

20. Nanev, L. Ilievski, J. Jakovcevska, L., "Procedura për veprim me fëmijën viktimë", Dhjetor, 2014
21. Raporti Inicial I Shteteve Nënshkruese i vitit 1993: Kroacia, UN. DOC.CRC/C/8
22. Sahiti, E., & Zejneli, I." E Drejta e Procedurës Penale e Republikës së Maqedonisë", 2017, UEJL
23. Shegani, A., E Drejta Penale e Krahasuar, 2002, Tiranë
24. Turkeshi. E., Masat edukuese të parashikuara në Kodin Penal dhe zbatimii tyre në Shqipëri", Revista Shqipëtare për studime Ligjore, Vol. 1., 2011
25. "Udhëzimet e Këshillit të Evropës mbi Strategjitë e integruara kombëtare për mbrojtjen e fëmijëve nga dhuna", Këshilli i Evropës, Strasburg www.coe.int/children
26. Zejneli, I., Delikuenca e fëmijëve në Republikën e Maqedonisë, 2010, UEJL

Të dhëna statistikore nga faqet zyrtare të Byrove për statistika

1. Byroja për statistika e RMV www.stat.gov.mk
2. Byroja për statistika e R. Shqipërisë www.instat.gov.al
3. Byroja për statistika e R. Kroacisë www.dsz.hr
4. https://w3.unece.org/PXWeb2015/pxweb/en/STAT/STAT_30-GE_07-CV/ZZZ_en_GECr_ConvictedPerson_r.px

Artikuj online:

<http://avokatia.al/revista/13-avokatia-27/33-horizonte-27>

<https://www.savethechildren.org/content/dam/usa/reports/annual-report/annual-report/sc-2012-annualreport.pdf>

<https://op.europa.eu/en/publication-detail/-/publication/7cf35124-e954-4d4c-a8ac-5b47f00cad73/language-en>

Lista e tabelave

Tabela nr. 1 Numri i përgjithshëm i fëmijëve të paraqitur, të akuzuar dhe të dënuar gjatë intervalit kohorë nga viti 2017 deri më vitin 2019 në RMV.....	22
Tabela nr. 2 Numri i krimeve të realizuara nga fëmijë gjatë intervalit kohorë nga viti 2017 deri më vitin 2019 në RMV	56
Tabela nr. 3 Numri i përgjithshëm i fëmijëve të gjykuar sipas gjinisë gjatë intervalit kohorë nga viti 2017 deri më vitin 2019 në RMV	56
Tabela nr. 4 Numri i fëmijëve të gjykuar nga mosha 14-16 gjatë intervalit kohorë nga viti 2017 deri më vitin 2019 në RMV	57
Tabela nr. 5 Numri i fëmijëve të gjykuar nga mosha 16-18 gjatë intervalit kohorë nga viti 2017 deri më vitin 2019 në RMV	57
Tabela nr. 6 Numri i fëmijëve që u janë shqyrtuar masa sanksionimi në bazë të veprave penale të kryera gjatë intervalit kohor nga viti 2017 deri më vitin 2019 në RMV	57
Tabela nr. 7 Fëmijë të gjykuar sipas rrethit familjar dhe grupeve të veprave penale të kryera gjatë intervalit kohorë nga viti 2017 deri më vitin 2019 në RMV.....	60
Tabela nr. 8 Numri i fëmijëve të përfshirë në vëpra penale sipas veprës penale në Kroaci në vitin 2015.....	60
Tabela 8.1 Kohëzgjatja e dënimit sipas veprës penale të kryer dhe numri i fëmijëve të dënuar në Kroaci në vitin 2015.....	61
Tabela 8.2 Masat e sanksionimit të fëmijëve madhorë dhe të fëmijëve të rinjë.....	62
Tabela nr. 9 Numri i fëmijëve të përfshirë në vëpra penale sipas veprës penale të kryer në Kroaci për vitin 2016.....	62
Tabela 9.1 Kohëzgjatja e dënimit sipas veprës penale të kryer dhe numri i fëmijëve të dënuar në Kroaci në vitin 2016.....	63
Tabela 9.2 Masat e sanksionimit të fëmijëve madhorë dhe të fëmijëve të rinjë.....	64
Tabela nr. 10 Numri i fëmijëve të përfshirë në vëpra penale sipas veprës penale të kryer në Kroaci për vitin 2017	64
Tabela 10.1 Kohëzgjatja e dënimit sipas veprës penale të kryer dhe numri i fëmijëve të dënuar në Kroaci në vitin 2017.....	65
Tabela 10.2 Masat e sanksionimit të fëmijëve madhorë dhe fëmijëve të rinjë.....	66
Tabela nr. 11 Numri i fëmijëve të përfshirë në vëpra penale sipas veprës penale të kryer në Kroaci për vitin 2018	66
Tabela 11.1 Kohëzgjatja e dënimit sipas veprës penale të kryer dhe numri i fëmijëve të dënuar në Kroaci në vitin 2018.....	67
Tabela 11.2 Masat e sanksionimit të fëmijëve madhorë dhe të fëmijëve të rinjë.....	68
Tabela nr. 12 Vepra penale dhe procedura penale të paraqitura gjatë intervalit kohorë nga viti 2015 deri më vitin 2018 në Republikën e Shqipërisë	68
Tabela nr. 13 Numri i të fëmijëve autorë kryerës të veprës penale gjatë intervalit kohorë 2017 - 2019.....	70
Tabela nr. 14 Fëmijë të pandehur për vepra penale nga mosha 14- 17 gjatë intervalit kohorë 2015 - 2019	70
Tabela nr. 15 Numri i fëmijëve të akuzuar sipas gjinisë gjatë intervalit kohorë 2015 - 2017	71
Tabela nr.16 Loji i veprave penale të kryera nga fëmijë ndarë në gjini gjatë intervalit kohorë 2015- 2017	71